




THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



GENDER AND THE JUDICIARY
in the Western Balkans



FemPlatz
UDRUŽENJE GRAĐANKI



Përgjigja gjyqësore ndaj femicidit në Ballkanin Perëndimor

Kuadri ligjor dhe praktika gjyqësore

**Përgjigja gjyqësore ndaj
femicidit në Ballkanin
Perëndimor – kuadri ligjor
dhe praktika gjyqësore**

Titulli:	Përgjigja gjyqësore ndaj femicidit në Ballkanin perëndimor – kuadri ligjor dhe praktika gjyqësore
Botuesi:	Qendra AIRE (Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë)
Për botuesin:	Biljana Braithwaite
Autor:	Kosana Beker, PhD
Redaktorë:	Sabina Đapo Vanja Radević
Përkthimi dhe redaktimi:	Adelina Albrahimi

Raporti në origjinal në anglisht është përkthyer gjithashtu në gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase

©2023 AIRE Centre

Dizajni nga:	Kliker Dizajn
Numri ISBN:	978-1-914005-04-6



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

» PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE	7
RRETH RAPORTIT RAJONAL	9
PREVALENCA E FEMICIDIT	14
PREZANTIMI I SITUATËS DHE GJETJET KRYESORE	18
Shqipëria.....	18
Kuadri ligjor	18
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin.....	21
BOSNJE DHE HERZEGOVINA	29
Kuadri ligjor	29
Federata e Bosnjë dhe Herzegovinës.....	
Republika Srpska	
Distrikti Brčko.....	
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin.....	33
KOSOVA	44
Kuadri ligjor	44
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin.....	47
MALI I ZI	52
Kuadri ligjor	52
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin.....	54
MAQEDONIA E VERIUT.....	60
Kuadri ligjor	60
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin.....	64
SERBIA	71
Kuadri ligjor	71
Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin	73

Vështrim i përgjithshëm mbi dënimet për vrasje dhe vrasje të rëndë në vendet e Ballkanit Perëndimor 86

REKOMANDIME 88

Parashikimi i femicidit si vepër penale 89

Krijimi i një sistemi kombëtar për mbledhjen e të dhënave dhe përmirësimi i bazave të të dhënave gjyqësore 90

Hartimi i udhëzimeve për trajtimin e çështjeve të femicideve..... 90

Trajnimi vazhdues për gjyqësorin 91

Krijimi i një mekanizmi monitorimi për femicidin në çdo shtet dhe krijimi i një mekanizmi rajonal monitorimi për femicidin..... 92

Shkëmbimet e njohurive dhe praktikave gjyqësore midis vendeve të rajonit 93

LITERATURA..... 95

» PARATHËNIE

E kam për kënaqësi dhe nder të prezantoj këtë botim të rëndësishëm mbi përgjigjen gjyqësore ndaj femicideve në Ballkanin Perëndimor. Kjo punë është ndërmarrë nga Kampionët Gjinator në Rrjetin Gjyqësor dhe vjen si rezultat i një angazhimi të përbashkët për të luftuar dhunën me bazë gjinore (DHBGJ) dhe femicidin në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

U jam mirënjohës të gjithë atyre që kanë kontribuar për këtë burim të vlefshëm. Ky botim është produkt i frymës bashkëpunuese të gjyqësorit, organeve qeveritare dhe shoqërisë civile, të gjithë të bashkuar për një qëllim të përbashkët, për të dalë si kampionë kundër DHBGJ-së dhe femicideve.

DHBGJ-ja shpesh fshihet pas dyerve të mbyllura, brenda marrëdhënieve personale dhe ndikimi i saj mund të jetë i thellë. Ajo merr shumë forma, nga dhuna fizike deri te mundimi psikologjik, madje duke arritur në sferën digjitale. Gratë përbëjnë shumicën dërrmuese të viktimave të DHBGJ-së. Ajo përbën qartë një formë diskriminimi ndaj grave, një shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të tyre themelore. DHBGJ-ja i kapërcen kufijtë, përshkuan gjithë Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Femicidi, vrasja e një gruaje për shkak të seksit, gjinisë dhe/ose roleve gjinore, është manifestimi më ekstrem dhe tragjik i DHBGJ-së. Ai karakterizohet nga urrejtja ose përbuzja ndaj grave. Ky fenomen duhet të luftohet me çdo kusht.

Gjykatat, prokurorët dhe autoritetet policore janë në vijën e parë të kësaj lufte. Më shpesh, viktimat fillimisht u drejtohen atyre për ndihmë. Detyra e tyre nuk është vetëm korrigjuese, por edhe parandaluese. Ata kanë për detyrë të mbrojnë gratë nga dhuna në familje. Për gjyqësorin, përgjigja e tij ndaj femicideve shtrihet përtej sallës së gjyqit. Vendimet e gjyqtarëve kanë fuqinë për të sjellë jo vetëm autoritet e krimeve para drejtësisë, por edhe për të formësuar normat shoqërore dhe për të mbrojtur të drejtat themelore të grave.

Misioni i këtij raporti është i qartë: t'u ofrojë gjyqtarëve, profesionistëve të së drejtës dhe institucioneve një mjet gjithëpërfshirës në luftën kundër femicideve. Ai është një burim i gjerë i njohurive, precedentëve dhe praktikave më të mira.

Raporti paraqet situatën aktuale lidhur me përgjigjen e gjyqësorit ndaj femicideve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ai jep një përmbledhje dhe bën një analizë të kërkimeve të gjera kombëtare të kryer nga organizata dhe individë të përkushtuar. Ai përmban të dhëna dhe statistika të vlefshme, ndonëse shkatërruese, mbi femicidin dhe përgjigjen e gjyqësorit ndaj tij; jep një pasqyrë të qartë të legjislacionit penal kombëtar përkatës; dhe përmban raste studimore që ilustrojnë qasjen e ndërmarrë në shtete të ndryshme. Ai jo vetëm që merr parasysh pozicionin aktual, por është edhe largpamës, për shkak se merr parasysh se çfarë duhet të ndryshojë dhe çfarë mund të mësojmë të gjithë ndërsa punojmë për ta kufizuar femicidin në histori.

Shpresoj se ky botim do të përdoret si një mjet nga gjyqësori, prokurorët dhe të tjerët për të rritur të kuptuarit dhe ndërgjegjësimin e tyre për femicidin, për të harmonizuar jurisprudencën brenda Ballkanit Perëndimor me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet ndërkombëtare dhe, më e rëndësishmja, për të luajtur një rol kryesor në luftimin e femicidit.

Ne të gjithë kemi përgjegjësinë të mbrojmë barazinë gjinore, të respektojmë dhe të mbrojmë të drejtat e grave dhe të kundërshtojmë diskriminimin dhe dhunën. Së bashku, ne duhet të punojmë pa u lodhur për të çrrënjësuar femicidin. Ju ftoj të gjithëve ta shfrytëzoni plotësisht këtë botim.

Me respekt,

Robert Spano

Ish-kryetar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Kryetar i Bordit të Mbrojtësve

» RRETH RAPORTIT RAJONAL

Raporti rajonal mbi përgjigjen gjyqësore ndaj femicideve në Ballkanin Perëndimor është versioni i shkurtuar dhe i përshtatur i kërkimeve kombëtare mbi femicidin të kryer në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor gjatë tre viteve të fundit.

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2021, Shoqata e Qytetareve Femra FemPlatz dhe Qendra Kërkimore e Grave për Edukim dhe Komunikim e Serbisë filluan të zhvillojnë një kuadër për të kuptuar karakteristikat, modelet dhe shkaqet e femicideve në Serbi, si manifestimi më ekstrem i dhunës ndaj femrat.^[1] Procesi përfshiu zhvillimin e një metodologjie kërkimore, punën në zyrë, mbledhjen e të dhënave, analizën e të dhënave të mbledhura sasiore dhe cilësore dhe rezultoi në punën e parë kërkimore ndërdisiplinore mbi përgjigjen shoqërore dhe institucionale ndaj femicideve në Serbi.^[2]

Duke pasur parasysh kontekstin e ngjashëm social dhe gjeopolitik, si dhe dhunën e përhapur ndaj grave, i njëjti studim u përsërit në Mal të Zi dhe Shqipëri.^[3] Metodologjia e përdorur në Serbi u përshtat me kontekstet kombëtare dhe

-
- [1] Me mbështetjen e Zyrës Rajonale të UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore në kuadër të projektit “Çrrënjësja dhe parandalimi i femicideve në Serbi”.
- [2] Konstantinović Vilić Slobodanka, Petrušić Nevena, Beker Kosana, Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Srbiji I, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo, 2019, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2019-11_Femicid_monografija_Prva_publicacija_E_primerak.pdf; Petrušić Nevena, Žunić Natalija, Vilić Vida, Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Srbiji II, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo, 2019, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2019-11_Femicid_monografija_Druga_publicacija_E_primerak.pdf and Konstantinović Vilić Slobodanka, Petrušić Nevena, Pokušaji femicida i femicid u Srbiji: Sprečavanje i procesuiranje, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo & Niš, 2021, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2021-04_Femicid_-_Pokusaj_femicida_i_femicid_u_Srbiji.pdf
- [3] Shoqata e Qytetareve Femra FemPlatz zbatoi projektin “Përsëritja e Modelit të Vëzhgimit të Femicideve të zhvilluar në Serbi në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe Hedhja e Bazave për Krijimin e Vëzhgimit Rajonal të Femicideve” në partneritet me Linjën Ndihmëse për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Dhunës nga Nikshiqi, Mali i Zi dhe Qendra për Iniciativa Ligjore Qytetare, Tiranë, Shqipëri, me mbështetjen e Zyrës Rajonale të UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore dhe financuar nga Bashkimi Evropian në periudhën nga shtatori 2021 deri në nëntor 2022.

përfshiu: punë kërkimore në zyrë lidhur me kuadrin ligjor në lidhje me dhunën ndaj grave, duke përfshirë edhe femicidin; mbledhjen e të dhënave për vendimet gjyqësore të formës së prerë në rastet e femicideve dhe tentativës për femicide (pavarësisht cilësimit të veprës penale) për periudhën 2017-2020; analizën sasiore të proceseve gjyqësore; një analizë të thelluar të dosjeve të përzgjedhura të çështjeve gjyqësore në formë të rasteve studimore; vlerësimet e kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve përkatës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave; intervista me autorë të dënuar për femicide, të cilët aktualisht janë duke vuajtur dënimin me burg. Studimet për Shqipërinë^[4] dhe Malin e Zi^[5] janë të disponueshme në gjuhët përkatëse, ndërsa përmbledhjet ekzekutive e tyre është e disponueshme edhe në anglisht.^[6] Metodologjia e përdorur është e njëjtë në të tria shtetet, duke bërë kështu të mundur krahasimin ndërmjet tyre.

Hulumtimet e kryera në Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri u mbledhën, u shkurtuan dhe u krahasuan, proces i cili çoi në shkrimin e raporteve rajonale mbi përgjigjen shoqërore dhe institucionale ndaj femicideve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi.^[7]

Paralelisht me studimin mbi femicidin të kryer nga FemPlatz dhe organizatat partnere në tre shtetet e sipërpërmendura të BP-së, Qendra AIRE,^[8] në kuadër të projektit «Rritja e kapaciteteve gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë me qëllim harmonizimin e praktikës gjyqësore të brendshme dhe përputhshmërinë me standardet ligjore evropiane», njohu rëndësinë e temës dhe mbështeti një hulumtim të ngjashëm në Bosnje dhe Hercegovinë. Hulumtimi mbi përgjigjen gjyqësor ndaj femicideve në Bosnje dhe Hercegovinë u krye nga Qendra AIRE

[4] Hysi Vasilika, *et.al*, Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020), Qendra për Iniciativat Ligjore Qytetare (QNL), Tiranë, 2023, mund ta gjeni në: <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>

[5] Beker Kosana (ed.), Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Crnoj Gori, SOS Nikšić, 2023, mund ta gjeni në: <https://sosnk.org/wp-content/uploads/2023/04/Drustveni-i-institucionalni-odgovor-na-femicid-u-Crnoj-Gori-1.pdf>

[6] Përmbledhje ekzekutive për Shqipërinë, mund ta gjeni në: <https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Social-and-Institutional-Response-to-Femicide-in-Albania.pdf>; Përmbledhje ekzekutive për Malin e Zi, mund ta gjeni në: <https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Social-and-institutional-response-to-femicide-in-Montenegro1.pdf>

[7] Beker Kosana, Raporti rajonal: Përgjigjet sociale dhe institucionale ndaj femicideve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi, UN Women & FemPlatz, mars 2023, mund ta gjeni në: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Regional-Report_Social-and-Institutional-Response-to-Femicide.pdf

[8] Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://www.airecentre.org/the-aire-centre>

dhe FemPlatz, si pjesë e aktiviteteve më të gjera të Qendrës AIRE në Bosnje dhe Hercegovinë, që synojnë forcimin e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardeve të saj. Aktivitetet përfshinë gjithashtu bashkëpunimin me gjykatat dhe qendrat më të larta për edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe pjesëmarrjen në hartimin e publikimeve dhe raporteve të rregullta dhe periodike.

Hulumtimi mbi praktikën gjyqësore të gjykatave në Bosnje dhe Hercegovinë lidhur me çështjet e femicideve është rezultat i bashkëpunimit intensiv me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Gjykatës Supreme të Republikës Srpska dhe Gjykatës së Apelit të distriktit Brçkos. Ky studim përfshin një analizë të kuadrit ligjor që mbulon krimin e vrasjes në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe një analizë të jurisprudencës që mbulon cilësimin ligjor të veprave penale, karakteristikat fenomenologjike të krimeve të kryera, profilet e autorëve, profilet e viktimave, sanksionet penale, kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, si dhe mënyrën se si trajtohen kërkesat civile për dëmshpërblim. Për sa i përket pjesës cilësore të hulumtimit, botimi paraqet shumë çështje të paraqitura në hollësi.^[9] Në hulumtimin për Bosnjë dhe Hercegovinën, u përdor e njëjta metodologji e zhvilluar nga FemPlatz në lidhje me praktikën gjyqësore. Megjithatë, për shkak të fokusit ekskluzivisht të gjyqësori, ky hulumtim nuk përmban pjesë që lidhen me vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve të ngarkuar me detyrën e parandalimit dhe mbrojtjes së dhunës ndaj grave. Megjithatë, e njëjta metodologji për hulumtimin e përgjigjes gjyqësore siguron krahasueshmëri me hulumtimet e tjera të kryera për femicidet në rajon.

Gjatë vitit 2022 dhe 2023, u kryen dy hulumtimet e tjera lidhur me përgjigjen e gjyqësorit ndaj femicidit përkatësisht në Maqedoninë e Veriut me mbështetjen e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe në Kosovë, me mbështetjen e Gjykatës Kushtetuese. Të dy hulumtimet u kryen në kuadër të projektit të Qendrës AIRE "Barazia gjinore dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe femicideve në Ballkanin Perëndimor", financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Projekti synon të rrisë qasjen në drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore përmes rritjes së të kuptuarit të çështjeve gjinore në gjyqësorin e Ballkanit Perëndimor, përmes punës analitike që synon të mbushë mangësitë në përputhje me praktikën e mira dhe standardet ndërkombëtare, rritjes së përafrimit të praktikës gjyqësore në BP6 për dhunën me bazë gjinore dhe

[9] Beker Kosana, Tanović Dalida (eds.), Analiza prakse sudova u procesuiranju femicida i pokušaja femicida u Bosni i Hercegovini 2017-2021, AIRE Centre, 2022, mund ta gjeni në: <https://www.airecentre.org/Handlers/Download.ashx?IDMF=77975c73-9c31-4552-9a68-3013255c0d5f>

femicidet me praktikën e mirë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe standardet ndërkombëtare, rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimit për çështjet gjinore midis gjyqtarëve dhe profesionistët e tjerë të gjykatave, dhe përfshirjen e barazisë gjinore në praktikat gjyqësore në të gjashtë juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor. Hulumtimet për Maqedoninë e Veriut^[10] dhe Kosovë^[11] përfshijnë analizën e kornizës ligjore kombëtare në lidhje me vrasjet, analizën e praktikës gjyqësore të çështjeve të femicideve dhe tentativave për femicide për periudhën 2018-2022, si dhe disa raste të femicideve që janë paraqitur në hollësi, në formën e rasteve studimore.

Ky raport rajonal përqendrohet vetëm te femicidi, ndërsa raportet kombëtare përfshijnë gjithashtu kuadrin ligjor që lidhet me dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Duke pasur parasysh se në kohën e kryerjes së hulumtimeve, shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk e kishin të parashikuar femicidin si vepër penale të pavarur, studiuesit mblodhën të gjitha rastet e vrasjeve të grave nga burrat dhe më pas analizuan nëse vrasjet kishin lidhje gjinore. Raporti është i ndarë në gjashtë pjesë, një pjesë për secilin shtet, dhe gjendjet janë paraqitur sipas rendit alfabetik. Së pari, për çdo shtet, jepet kuadri ligjor kombëtar që lidhet me lloje të ndryshme vrasjesh dhe më pas analizohet praktika gjyqësore, e cila pasohet nga disa raste studimore nga secili shtet. Rastet studimore jepen të detajuara. Në fund jepen disa rekomandime të rëndësishme, relevante dhe të zbatueshme për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor, ndërsa rekomandimet më konkrete për secilin shtet jepen si pjesë e raporteve kombëtare.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të paraqesë, shumë shkurt, gjendjen aktuale të përgjigjes gjyqësore ndaj femicideve në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Një pasqyrë e shkurtër ligjore u mundëson lexuesve të njihen me legjislacionin përkatës kombëtar penal në lidhje me llojet e ndryshme të vrasjeve, sepse ky është legjislacioni që përdoret nga prokurorët dhe gjyqtarët kur bëhet fjalë për cilësimin e veprave penale. Për më tepër, dy raste studimore të përzgjedhura për secilin shtet japin një panoramë të shkurtër të proceseve gjyqësore dhe sanksioneve të

[10] Габер-Дамјановска Наташа and Гајдова Габриела, *Фемидот во Република Северна Македонија – состојба, правна рамка и судска пракса (2018-2022)*, AIRE Centre, 2023, mund ta gjeni në: http://femplat.org/library/publications/2023-09_femicide-report-nmk-2023-nmk.pdf [Gaber-Damjanovska Natasha and Gajdova Gabriela, *Femicidi në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Gjendja, kuadri ligjor dhe praktika gjyqësore (2018-2022)*, AIRE Centre, 2023, mund ta gjeni në: <https://gcjnetwork.org/femicide-report-nmk-2023-eng-4/>].

[11] Do të botohet në dimrin e 2023-it, dhe do të mund ta gjeni online në faqet e intertentit të Qendrës AIRE dhe FemPlatz-it.

vendosura ndaj autorëve të femicideve, ndërsa komentet e dhëna janë hartuar për të shërbyer si kujtesë se çfarë duhet bërë ndryshe për të siguruar përgjigjen e duhur të gjyqësorit ndaj femicidit. Ky raport, edhe pse jo i natyrës krahasuese analitike, mund të përdoret për krahasim ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe mund të kontribuojë për harmonizimin e procedurave dhe përmirësimin e përgjigjeve gjyqësore ndaj femicideve.

» PREVALENCA E FEMICIDIT

Gratë përbëjnë shumicën dërrmuese të viktimave të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, dhe autorët e dhunës janë kryesisht burra.^[12]

Femicidi, i përkufizuar si vrasja e një gruaje për shkak të seksit, gjinisë, roleve gjinore, është manifestimi më ekstrem i dhunës ndaj grave dhe karakterizohet nga urrejtja ose përbuzja ndaj grave, dëshira për të dominuar një grua dhe për të kontrolluar jetën e saj.^[13] Femicidi në marrëdhëniet familje-partner përbën një pjesë të konsiderueshme të të gjitha vrasjeve të grave në botë^[14] dhe shumica e vrasjeve të grave dhe vajzave janë të motivuara nga shkaqe gjinore.

Në nivel global, në vitin 2021, rreth 45,000 gra dhe vajza u vranë nga partnerët e tyre intimë ose anëtarë të tjerë të familjes, që është më shumë se pesë gra ose vajza të vrara çdo orë. Gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë jo proporcionale nga dhuna vrasëse në sferën private, përkatësisht 56% e të gjitha vrasjeve të femrave kryhen nga partnerë intimë ose anëtarë të tjerë të familjes.^[15]

Duke pasur parasysh se femicidi nuk është parashikuar si vepër penale e pavarur në vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Maqedonisë së Veriut kohët e fundit, është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të monitorohen dhe analizohen siç duhet rastet e femicidit. Statistikat zyrtare kombëtare nuk japin të dhëna të veçanta për femicidin. Për rrjedhojë, nuk ka të dhëna të disponueshme publikisht për këtë fenomen të përhapur shoqëror.

Sa i përket statistikave ndërkombëtare, për shembull, të dhënat e UNODC-së për viktimat e vrasjeve me dashje për periudhën 2019-2021 treguan përqindjet e mëposhtme të grave të vrarë (për 100.000):

[12] Beker Kosana, 2023, *op. cit.*, f. 35.

[13] Konstantinović Vilić Slobodanka, Petrušić Nevena, Beker Kosana, 2019, *op. cit.*, f. 7.

[14] *Po aty.*, f. 412.

[15] Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, UN Women, Vrasjet gjinore të grave dhe vajzave (femicidi/femicidit), 2022, mund ta gjeni në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-11/Gender-related-killings-of-women-and-girls-improving-data-to-improve-responses-to-femicide-femicidit-en.pdf>

UNODC – Nivelet e grave të vrara në periudhën 2019-2021^[16]

	2019	2020	2021
Shqipëria	0.91	0.63	0.84
Bosnje dhe Hercegovina	0.59	0.30	0.42
Kosova	0.35	0.96	0.36
Mali i Zi	1.55	0.93	0.62
Maqedonia e Veriut	0.38	n/a	n/a
Serbia	0.73	0.57	0.71

Nga ana tjetër, të dhënat nga Rishikimi i Popullsisë Botërore për nivelet e femicideve për shtet për vitin 2023 tregojnë se Shqipëria ka shkallën më të lartë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor (1.1), e pasuar nga Maqedonia e Veriut (0.9), Serbia dhe Mali i Zi me të njëjtën shkallë të femicideve (0.6), Bosnja dhe Hercegovina (0.5), ndërsa për Kosovën nuk ka të dhëna të disponueshme.^[17]

Për qëllime të hulumtimeve kombëtare mbi femicidin, organizatat partnere^[18] mblodhën të dhëna të disponueshme për gratë e vrara nga artikujt e raportuar nga mediat dhe nga burime të tjera të disponueshme. Në tabelën më poshtë, jepen të dhënat për periudhën 2020-2022, së bashku me popullsinë e vlerësuar në fund të vitit 2021.

[16] Të dhënat e UNODC për viktimat e vrasjeve me dashje për periudhën 2019-2021, mund ta gjeni në: <https://dataunodc.un.org/dp-intentional-homicide-victims>

[17] Rishikimi i Popullsisë Botërore publikoi normat e femicideve sipas shteteve për vitin 2023, mund ta gjeni në: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/femicide-rates-by-country>

[18] CLCI për Shqipërinë, Qendra për të Drejtat e Grave Zenica për Bosnje dhe Hercegovinën, zyrtarë të Gjykatës Kushtetuese për Kosovën, SOS Nikshiq për Malin e Zi, profesionistë nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë për Maqedoninë e Veriut dhe FemPlatz Pançevo për Serbinë. Të dhënat janë mbledhur nga raportet e mediave dhe burime të tjera të disponueshme.


Numri i femicideve në Ballkanin Perëndimor dhe popullsia e vlerësuar në vitin 2021

	2020	2021	2022
Shqipëria (2.8 milionë)	9	7	7
Bosnje dhe Hercegovina (3.3 milionë)	12	9	11
Kosova (1.8 milionë)	4	3	3
Mali i Zi (620.000)	1	2	2
Maqedonia e Veriut (2.1 milionë)	4	7	1
Serbia (6.8 milionë)	27	26	27

Së fundi, për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, duke pasur parasysh faktin se femicidet janë të përhapura gjerësisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor, FemPlatz zhvilloi **hartën interaktive të femicideve**.^[19] Aktualisht, ka të dhëna për tre vende të BP-së, por së shpejti harta do të zgjerohet për të përfshirë të gjashtë shtetet e BP-së. Kjo hartë ndëraktive shfaq dhe përshkruan femicidet e kryera që nga viti 2020 në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Përveç kësaj, që nga fillimi i tetorit 2023, janë të disponueshme të dhënat për femicidet në Republikën e Kroacisë.

Harta synon të gjurmtojë të dhënat për femicidet, si dhe të shërbejë si një model i një harte publike, transparente që mund të zhvillohet sipas zhvillimeve të mundshme të lidhura me femicidet, mekanizmave për të monitoruar femicidin në rajon. Informacioni për femicidin e paraqitur në hartë është mbledhur nga media dhe nuk përfaqëson një burim zyrtar informacioni. Ai u drejtohet autoriteteve shtetërore dhe aktorëve të tjerë si një model i prezantimit të të dhënave publike për iniciativat e ardhshme të vëzhgimit të femicideve.

[19] Harta ndëraktive për femicidin, FemPlatz, mund ta gjeni në: <http://femplatz.org/index.php?t16>



» PREZANTIMI I SITUATËS DHE GJETJET KRYESORE

Shqipëria

Kuadri ligjor

Femicidi nuk është i parashikuar si vepër penale më vete në Shqipëri. Legjislacioni penal përfshin aktet penale të dhunës, disa prej të cilave lidhen me marrëdhënie familjare ose marrëdhënie intime që nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me familjen, sipas një seksioni të veçantë të Kodit Penal, si dhe vrasjet dhe sanksionet për lloje të ndryshme vrasjesh.^[20] Ligji tjetër i rëndësishëm është Kodi i Procedurës Penale (KPP) i Republikës së Shqipërisë.^[21]

Kodi Penal parashikon disa vepra penale të cilat në rrethana të caktuara mund të cilësohen si femicide:^[22]

- » Vrasje me dashje (neni 76);
- » Vrasje me paramendim (neni 78);
- » Vrasje në rrethana të tjera, të tilla si vrasje me dashje e kryer kundër:
 - » një minoreni;
 - » një personi me paaftësi fizike ose psikologjike, të sëmurë rëndë, ose shtatzënë, kur situata është e dukshme ose e njohur (neni 79);
- » vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c);
- » vrasje në kushtet e traumës së rëndë psikologjike (neni 82);
- » dëmtim i rëndë i qëllimshëm që çon në vdekje (neni 88, paragrafi 2);

Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c i KP-së) përcakton se vrasja me dashje e një personi që është bashkëshorti, ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi, i afërm ose relativisht i afërt me autorin, dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose burgim të përjetshëm. Kodi Penal në nenin 50/j parashikon si rrethanë rënduese edhe veprat e vrasjes për shkak të gjinisë së personit.

[20] Ligji nr. 7905, datë 21 mars 1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

[21] Ligji nr. 7905, datë 21 mars 1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë".

[22] Aktet e dhunshme kriminale përfshihen në kreun II të Kodit Penal, nenet I, II, III, IV, V dhe VI, disa prej të cilave janë të lidhura ngushtë me vepra të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare.

Neni 88 i Kodit Penal parashikon veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje në rrethana rënduese kur kjo veprë penale kryhet kundër disa personave, ndaj një personi që është bashkëshorti, ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi ose ish-bashkëjetuesi, i afërm, ose vjehri i autorit të veprës, ose kur lëndimi i tillë ka sjellë si pasojë vdekjen. Për sa i përket veprave penale të dhunshme, Kodi Penal përmban një sërë dispozitash që lidhen me krimet seksuale, përfshirë dhunën seksuale, përdhunimin dhe ngacmimin seksual.

Në periudhën nga viti 2012 deri në 2021, janë bërë disa ndryshime të konsiderueshme në legjislacionin civil, administrativ dhe penal në Shqipëri. Sigurimi i mbrojtjes për viktimat, gratë dhe të miturit në sistemin e drejtësisë penale ishte pjesë e reformës së drejtësisë penale, në kuadrin më të gjerë të reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri (2015 – 2020). Një vështirësi në përgjithshëm i ligjit penal për aktet që lidhen me femicidin zbulon se legjislacioni penal procedural i Shqipërisë është përmirësuar gjatë dekadës së fundit. Disa nga këto përmirësime erdhën si rezultat i rritjes së numrit të krimeve, të tjera si rezultat i nevojës për përafrimin e ligjeve penale shqiptare sipas standardeve ndërkombëtare.^[23] Ndryshimet dhe përmirësimet kryesore jepen më poshtë:

- » Ngacmimet seksuale dhe marrëdhëniet seksuale me dhunë ndërmjet bashkëshortëve ose bashkëjetuesve janë parashikuar si vepra penale dhe bëjnë dallimin midis dhunës seksuale, marrëdhëniesve seksuale, akteve të pahijshme dhe ngacmimeve seksuale;^[24]
- » Marrëdhëniet seksuale ndërmjet bashkëshortëve ose bashkëjetuesve pa pëlqimin e njërit prej tyre janë parashikuar si vepra penale;^[25]
- » Janë rritur dënimet në rastet e trafikimit të grave dhe vajzave për qëllime të ndryshme, duke përfshirë shfrytëzimin për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërinë ose forma të ngjashme të skllavërisë, përdorimin ose transplantimin e trupave, si dhe forma të tjera të shfrytëzimit, brenda dhe jashtë territorit

[23] Hysi, Vasilika, Veprat penale ndaj grave dhe fëmijëve dhe politikat kundër krimit në Shqipëri, Reflektime mbi ndryshimet në Kodin Penal (2012-2013), "Studime Juridike" nr. 2, 2014, Departamenti Juridik, Universiteti i Tiranës.

[24] Ndryshimet synonin të harmonizonin ligjin penal shqiptar me Konventën e Stambollit dhe Konventën e KiE-s për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (nenet 3 dhe 18). Shqipëria ka ratifikuar Konventën më të vonë me ligjin nr. 10071, datë 9 shkurt 2009.

[25] Neni 102 i Ligji nr. 144/2013 "Për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27 janar 1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

të Shqipërisë.^[26] Ligji i ndryshuar konsideron si vepër penale në rrethana rënduese rastet kur përfshihen të mitur, të afërm të afërt, bashkëshortë, kujdestarë ose persona me të cilët kanë marrëdhënie zyrtare ose kur vepra kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike;

- » Përndjekja është shtuar si vepër e re penale.^[27] Kodi Penal parashikon se ka rrethana rënduese kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi ose personi që ka qenë në marrëdhënie intime me të dëmtuarin; kur kryhet kundër një të mituri, një gruaje shtatzënë ose një personi të paaftë për t'u mbrojtur dhe kur kryhet nga një person që mban maskë ose një person që mban ose përdor armë;
- » U prezantua vepra e re penale e dhunës në familje.^[28] Dispozitat e reja përfshijnë sulmin dhe çdo akt tjetër dhune ndaj anëtarëve të familjes; kërcënimet serioze për të vrarë ose për t'i shkaktuar lëndime të rënda trupore një anëtar të familjes; lëndimin e lehtë të qëllimshëm dhe lëndimin e qëllimshëm që çon në paaftësi të përkohshme për të punuar për më shumë se nëntë ditë;
- » U shtua edhe vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare, duke parashikuar një dënim jo më pak se 20 vjet burg ose burgim të përjetshëm;^[29]
- » Vepra penale e sulmit të rëndë trupor është ndryshuar për rritjen e dënimit për një vepër të kryer ndaj bashkëshortit, ish-bashkëshortit, bashkëjetuesit ose ish-bashkëjetuesit ose të afërmit të autorit, ose kur çon në vdekje.^[30]
- » Janë shtuar rrethanat rënduese në rastet kur veprat kryhen në kundërshtim me urdhrat e ndalimit, duke përdorur marrëdhënie familjare, me motivacion gjinor, identiteti gjinor dhe/ose preferencë seksuale.^[31]

Gjithashtu, rrethanat lehtësuese^[32] u qartësuan në vitin 2013, pasi *vepra penale e kryer për motive të vlerave pozitive morale dhe shoqërore* nuk e ul dënimin nëse vepra është kryer për motive të lidhura me gjininë, racën, ngjyrën, përkatësinë etnike, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose

[26] Neni 110/a i KK-së.

[27] Neni 121/a i KP-së, i ndryshuar me Ligjin Nr. 23/2012, datë 1 mars 2012

[28] Neni 130/a i KP-së, i ndryshuar me Ligjin Nr. 23/2012. "Për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

[29] Neni 79/c i KP-së.

[30] Neni 88/2 i KP-së, i shtuar me Ligjin nr.144/2013, neni 18.

[31] Ligji nr. 144/2013 "Për shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

[32] Neni 48 i KP-së. Dy paragrafët e fundit janë shtuar me ligjin nr.144, datë 05.02.2013, neni 5.

filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozitën gjenetike ose paaftësitë. Po kështu, rrethanat lehtësuese të marrëdhënive të normalizuara ndërmjet autorit të veprës penale dhe viktimës nuk çojnë në ulje të dënimit për personin që kryen veprën penale ndaj fëmijëve, apo një veprën penale që lidhet me dhunën në familje.

Dispozita për rrethanat rënduese u ndryshua në vitin 2013^[33] duke shtuar si rrethanë të re rënduese kryerjen e veprës penale pas vënies nën monitorim elektronik.^[34] U ndryshuan edhe dy paragrafë të tjerë për të qartësuar dhe harmonizuar legjislacionin me Konventën e Stambollit, konkretisht kur vepra kryhet duke përfitur nga familja, bashkëjetesa, miqësia, marrëdhëniet pritëse^[35] dhe kur vepra kryhet për motive që lidhen me gjininë, racën, ngjyrën, përkatësinë etnike, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, besimet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozitën gjenetike ose paaftësitë.^[36]

Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka kryer hulumtime mbi vendimet e gjykatave në lidhje me femicidin në Shqipëri gjatë periudhës 2017-2020, nëpërmjet monitorimit, analizimit dhe vlerësimit të vendimeve të gjykatave shqiptare.^[37] Analiza e praktikës gjyqësore bazohet në studimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë gjatë periudhës së monitorimit. U studiuan veprat penale të femicidit dhe vrasjes së mbetur në tentativë, profili i autorit, viktimës dhe raporti autor-viktimë, faktorët që ndikojnë në dhunën ndaj grave, vepra penale e kryer, mënyra e kryerjes së saj, aspekte të procedurat gjyqësore dhe vendimet penale. Duhet theksuar se anonimizimi i vendimeve dhe të dhënave për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale krijoi paqartësi dhe mungesë transparence, si dhe disa vendime gjyqësore ishin shumë të anonimizuara, gjë që i bëri ato të pakuptueshme për shkak të mungesës pothuajse të plotë të përmbajtjes.

[33] Neni 50 i KP-së. Germat “ç/1” dhe “e/1” u shtuan dhe germat “g” dhe “j” u ndryshuan me ligjin nr.144, datë 2 maj 2013, neni 6.

[34] Neni 50 e/1 i KP-së.

[35] Neni 50/g i KP-së.

[36] Neni 50/j i KP-së.

[37] Hysi Vasilika, Anastasi Aurela, Bozo Aurela and Vora Erisa, *Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020)*, Qendra për Iniciativa Ligjore Qytetare, Tiranë, 2023, mund ta gjeni në: <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>

Të dhënat sasiore

Nga praktika gjyqësore e mbledhur, u analizuan 23 vendime të formës së prerë si femicide dhe tentativë për femicid. Në periudhën 2017-2020, shumica e vendimeve janë dhënë nga Gjykata e Krimeve të rënda (70%), ndërsa pjesa tjetër e vendimeve janë dhënë nga gjykatat e rretheve. Nga çështjet e analizuarat ishin gjithsej 33 vepra penale, prej të cilave 25 ishin vepra kryesore penale, duke përfshirë një rast të dhunës në familje. Shumica dërmuese e çështjeve janë cilësuar si vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare (75%), e pasuar nga vrasja në rrethana të tjera cilësuese, vrasje me paramendim dhe plagosje e rëndë me dashje, secila e përfaqësuar me 8.3%.

Shumica e veprave janë kryer në shtëpinë e përbashkët të viktimës dhe autorit. Për kryerjen e veprës penale janë përdorur metoda dhe armë të ndryshme, si: mjete të mprehta të disponueshme në banesë (sëpata, vare, shufra hekuri, thika), armë zjarri automatike etj. Tre të katërtat e autorëve nuk kanë pasur histori penale, dhe shumica e autorëve kanë qenë ligjërisht të aftë dhe mendërisht të përgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës. Rreth një e treta janë deklaruar të pafajshëm dhe në disa raste (21%) shprehën pendim gjatë gjykimit. Gratë janë më shpesh viktimat të femicideve nga burrat e tyre, por edhe nga anëtarët e tjerë të familjes, veçanërisht kur jetojnë së bashku. Shumica e viktimave kishin përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike përpara femicidit.

Praktika gjyqësore e analizuar nuk përmbante të dhëna gjithëpërfshirëse për profilet e viktimave dhe raportin dhunues-viktimë, ndërsa ajo i referohet rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Hetimi dhe gjykimi janë përqendruar te analiza e elementeve të veprës penale dhe në mënyrë rigorozë te vërtetimi i fajësisë së autorit. Krahas kuptimit dhe zbatimit të pabarabartë të ligjit, autorët kanë përfituar ulje të konsiderueshme të dënimeve për shkak të pranimit të kërkesave për gjykim të shkurtuar.^[38] Dënimet për veprat penale të femicideve ndryshojnë për disa arsye, në varësi të llojit të procedurës së ndjekur. Në përgjithësi, **gjykatat në shumicën e rasteve kanë dhënë vendim me burgim afatgjatë ose burgim të përjetshëm**. Gjetjet e kërkimit treguan se prokurorët dhe gjyqtarët kanë mbajtur pozicione të ndryshme në kualifikimin e veprës penale bazë.

[38] Sipas nenit 403 të KPP-së, kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të parashtrohet gjatë seancës paraprake, përfshirë edhe krimet më të rënda. Nga viti 2017, kjo nuk është më e mundur për veprat penale që mund të dënohen me burgim të përjetshëm.

Profili i autorëve të veprave

Nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 23 meshkuj kanë kryer vepër penale që në hulumtim është klasifikuar si femicide dhe tentativë për femicid. Shumica prej tyre e kanë kryer vetëm veprën penale dhe vetëm në dy raste kanë bashkëpunuar me një person tjetër. Për sa i përket moshës, shumica e autorëve të krimit në momentin e kryerjes së krimit ishin mbi 57 vjeç (50%), pasuar nga grupmosha 49-56 (17%), grupmosha 41-48 (13%), grupmosha 25-32 vjeç (13%) dhe nga 4% e grupmoshave 18-25 dhe 33-40 vjeç.

Në shumë vendime mungojnë të dhënat për nivelin arsimor të autorëve për shkak të mospërfshirjes së tyre në vendim, ose për shkak të anonimizimit të të dhënave (33%). Të dhënat e disponueshme tregojnë se autorët kryesisht kanë një nivel arsimor mesatar ose nën mesatar. Shumica e të pandehurve kanë arsim të mesëm (33%), pasuar nga ata me arsim 8-vjeçar (17%) dhe ata me arsim 8-vjeçar të papërfunduar (17%).

Tre të katërtat e autorëve kanë qenë të padënuar më parë, 21% e tyre janë dënuar për vepra të ndryshme penale, ndërsa 17% e tyre janë dënuar për dhunë në familje. Gjithashtu, praktika gjyqësore tregon se 86% e të pandehurve nuk kishin konsumuar alkool apo drogë në momentin e kryerjes së veprës penale.

Profili i viktimave

Në kampionin e praktikës gjyqësore përfshiheshin 27 viktima, shumica prej të cilave gra (89%). Megjithatë, ishte e mundur të mblidheshin informacione të përgjithshme vetëm rreth 37% e viktimave. Informacioni i pakët për viktimat nuk lejon njohjen e statusit të saj në familje, pozitën ekonomike dhe informacionin për të drejtat dhe mekanizmat e tyre mbrojtës, nëse ka pasur mbështetje nga familjarët dhe të afërmit e saj, qëndrimin e familjes së origjinës etj. Shumica e viktimave ishin të martuar (78%), disa ishin të divorcuar (11%) dhe përfshihej gjithashtu dhe një fëmijë (4%).

Jo të gjitha vendimet trajtojnë faktin nëse viktimat ka qenë më parë viktimë dhune (33%). Megjithatë, femicideve u paraprinte përdorimi i dhunës sistematike fizike dhe psikologjike. Shumica e viktimave janë dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht për një periudhë të gjatë (44%); janë abuzuar psikologjikisht (11%), dhe vetëm disa viktima nuk kanë pësuar dhunë më parë (15%). Disa nga viktimat ishin nën urdhër mbrojtje ose kishin urdhër mbrojtje më parë (19%).

Edhe pse rezulton se shumë prej viktimave janë keqtrajtuar sistematikisht nga autorët, për shumicën e viktimave (70%), vendimet e gjykatës nuk përmbajnë të dhëna nëse viktimat e dhunës kanë kërkuar ndihmë nga Policia apo nga ndonjë institucion tjetër. Gjithashtu, nuk ka të dhëna nëse viktimat i është drejtuar ndonjë organizatë të shoqërisë civile që ofron shërbime mbështetëse për gratë dhe vajzat e dhunuara. Megjithatë, në shumë raste, vendimet e gjykatave nxjerrin në pah dhunën që ka përjetuar viktimat nga dhunuesi dhe/ose anëtarët e familjes së tij.

Motivet

Disa nga autorët e kanë pranuar akuzën dhe kanë dhënë shpjegime për motivet e kryerjes së veprës penale ose janë bërë të qarta nga dëshmitë. Motivët bazë janë një nga shkaqet e krimeve në familje, megjithatë nuk jepen shumë detaje. Disa nga motivet e renditura janë: xhelozia; dyshimi se fëmijët nuk ishin të tij; problemet e shëndetit mendor; problemet ekonomike; lëshimi i një urdhri mbrojtjeje ose dënimi për dhunë në familje ose divorc; abuzimi me alkoolin i kombinuar me probleme ekonomike; dyshimi për tradhti bashkëshortore; refuzimi për të pasur marrëdhënie intime; hakmarrje pasi viktimat kishte akuzuar kunatin për vrasjen e motrës^[39] etj.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Disa nga rrethanat lehtësuese të përmendura në arsyetimin e vendimeve të gjykatës janë: mosha e autorit të veprës (mosha e re ose më e madhe); statusi familjar; pranimi i krimit; pendim i shprehur; etj. Sa i përket rrethanave rënduese, gjykatat deklaruan: rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe/ose autorit të veprës penale; pasojat e rënda të krimit (p.sh. shkaktimi i vdekjes së tre personave, duke përfshirë një të mitur dhe një grua shtatzënë); veprë penale e kryer për motive të ulëta; mohimin e krimit; dënimet e mëparshme; mënyrën e kryerjes së veprës penale (p.sh. të shtënat disa herë me armë në drejtim të personave të pambrojtur; përdorimin e armëve të zjarrit; të shtënat disa herë me armë zjarri në drejtim të gjithë familjes; përdorimin e armëve luftarake; krim i kryer brutalisht, duke e lënë viktimën të vuajë, intensiteti i sulmeve, helmimi dhe më vonë mbytja e viktimës); veprë e motivuar nga hakmarrja ndaj veprimeve të ish-bashkëshortes së dhunuar fizikisht; veprë penale e kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare me viktimat; motivet (xhelozia; dyshimi për tradhti bashkëshortore; hakmarrja); krimi i kryer në sy të fëmijëve; krimi i kryer gjatë masës së urdhrimit për mbrojtje;

[39] Për këtë çështje konkrete, ditën e ngjarjes, gjykata zhvillonte seancën e kujdestarisë për fëmijët e motrës së vvarë.

dënim i mëparshëm për dhunë në familje; asnjë pendim i shprehur; fakti që pas kryerjes së krimit, autori e ka detyruar viktimën të paraqesë dëmtimin e rëndë të shkaktuar si vetëdëmtim, për ta përjashtuar atë nga përgjegjësia ligjore, dhe fakti që autori është larguar nga vendi i ngjarjes dhe nuk është kujdesur për pasojat apo gjendjen shëndetësore të viktimave.

Raste studimore

Në studimin mbi Shqipërinë janë paraqitur pesë raste studimore. Këtu po prezantojmë shkurtimisht informacionin për dy raste të analizuara.

Rasti studimor nr. 1

I pandehuri F.R dhe viktima L.R ishin të martuar dhe kishin dy fëmijë të mitur. I pandehuri ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes së tij. Urdhri i mbrojtjes nga Gjykata është lëshuar më 11 nëntor 2016 dhe F.R është detyruar të mos i afrohet viktimës L.R në një distancë prej dy metrash, derisa ajo qëndronte në banesën bashkëshortore me fëmijët. Edhe pse ishte lëshuar urdhër mbrojtje, autori dhe viktima jetonin në të njëjtën banesë. Më 3 dhjetor 2016, policia mori një telefonatë që kërkonte një ambulancë pasi një grua ishte hedhur nga kati i katërt i pallatit. Më pas, policia ka regjistruar një telefonatë nga F. R (i pandehuri) i cili ka raportuar se ai ka kryer një krim. Vepra është cilësuar si vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.

Vendimi i gjykatës përmban pak informacion për të pandehurin dhe sjelljen e tij. Ai ishte 52 vjeç, pa dënime të mëparshme, i papunë, ndërsa nuk ka të dhëna për nivelin arsimor apo profesionin e tij. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, sjelljen, fëmijërinë etj., apo nëse ka pasur sjellje të dhunshme. Nga ekspertiza mjeko-ligjore rezulton se i pandehuri edhe më herët ka shfaqur sjellje të dhunshme ndaj viktimës. Gjithashtu, vendimi nuk përmban të dhëna për viktimën, moshën, arsimin, profesionin dhe punësimin dhe marrëdhënien me bashkëshortin e saj. I vetmi fakt në lidhje me marrëdhënien autor-viktimë vjen nga dëshmia e vëllait të të pandehurit, i cili ka deklaruar se marrëdhëniet mes të pandehurit dhe viktimës nuk kanë qenë të mira. Sipas mbrojtjes, shkak i krimit kanë qenë veprimet e viktimës, fyerjet, dhuna verbale dhe veprimet fizike ndaj të pandehurit, si kapja nga fytyra dhe gërvishtja. Fqinjët kanë treguar se viktima është hedhur nga kati i katërt i pallatit ku banonin dhe se personi që e ka hedhur ndodhej brenda në shtëpi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, vepra penale ka një rrezik të konsiderueshëm social. I pandehuri nuk i është përmbajtur urdhrin të mbrojtjes dhe nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara nga Gjykata. Vepra penale është kryer me dashje të drejtpërdrejtë dhe i pandehuri ka vazhduar të kryejë veprën derisa e ka vrarë viktimën. Gjykata nuk e pranoi mbrojtjen, duke u shprehur se *kundër reagimi në trajtën e dhunës së rëndë fizike, gjakderdhjes së viktimës, lënies së saj në gjendje të pavetëdijshme dhe më pas hedhja e saj nga dritarja e katit të katërt është jashtë çdo logjike njerëzore.*

Gjykata nuk konstatoi ndonjë rrethanë lehtësuese, ndërsa si rrethanë rënduese konsiderohet mosrespektimi i urdhrin të mbrojtjes, si dhe prania e fëmijëve të mitur. Fillimisht, autori u dënua me burgim të përjetshëm, por pasi pranoi kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, përfundimisht u dënua me 35 vite burg. Gjithashtu, gjykata nuk e pranoi kërkesën për dëmshpërblim të vëllait të viktimës dhe e referoi atë si padi civile.

Komente

Cilësimi i veprës penale ka qenë i saktë. Së pari, gjykata dha dënimin maksimal (burgim të përjetshëm), i cili u ndryshua në 35 vjet burg për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Para ndryshimeve të vitit 2017, nga pikëpamja ligjore, miratimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar nuk lidhej me rrezikshmërinë e veprës penale, por me mundësinë e gjykimit të çështjes duke pasur parasysh gjendjen e akteve. Në rastin konkret, autori ka përfituar nga fakti se ndryshimet nuk kishin hyrë ende në fuqi dhe çështja ishte gjykuar në bazë të legjislacionit të mëparshëm.

Është tregues se gjykata nuk e ka parë të nevojshme të mbledhë informacion në lidhje me masën e ndalimit që i ndalon autorit të kontaktojë me viktimën, ndonëse nga dëshmitarët dhe ekspertët e gjykatës mësoi se një masë e tillë ishte vendosur. Nëse gjykata do të kishte mbledhur këto fakte nga autoriteti përkatës, mund të kishte zbuluar një model të sjelljes së dhunshme të autorit ndaj viktimës dhe mund të analizonte më thellë marrëdhënien e tyre përpara vrasjes. Ky mosveprim i gjykatës është një nga arsyet e dhënies së një dënimi kaq të butë ndaj autorit.

KOSOVA

Kuadri ligjor

Femicidi nuk është term i përdorur shprehimisht në legjislacionin e Kosovës, siç është rasti edhe me vendet e tjera. Megjithatë, ekzistojnë disa vepra penale të cilat mund të përdoren në rastet e femicideve. Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.

06/L-074,^[48] në një kapitull kushtuar veprave penale kundër jetës dhe gjymtyrëve, parashikon këto krime:

- » vrasjen;
- » vrasjen e rëndë;
- » vrasjen e kryer në një gjendje të stresit të rëndë mendor;
- » vrasjen nga pakujdesia;
- » vrasjen e një foshnje gjatë lindjes.

Forma themelore e vrasjes përkufizohet si vijon: “Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër, dënohet me burgim jo më pak se pesë (5) vjet”. Dënimi për vrasje të rëndë parashikohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm. Ka disa forma të vrasjes së rëndë, pra për privimin nga jeta të:

- » një fëmije;
- » një gruaje shtatzënë;
- » një anëtar të familjes;
- » në mënyrë mizore ose mashtruese;
- » duke vënë në rrezik qëllimisht jetën e një ose më shumë personave të tjerë;
- » për qëllim të përfitimit material;
- » për qëllim të kryerjes ose fshehjes së një vepre tjetër penale, ose parandalimin e personit që të dëshmojë ose t'i japë në ndonjë mënyrë tjetër informacion policisë ose në procese penale;
- » për shkak të hakmarrjes së pashpirt ose për motive të tjera të ulëta, duke përfshirë hakmarrjen për të dëshmuar ose për të dhënë informacion në polici ose në procese penale;
- » kur personi është duke ushtruar detyrat e tij/saj zyrtare ose të lidhura me to;
- » për shkak të një motivimi të bazuar në kombësi, gjuhë, besim fetar ose mungesë besimi fetar, ngjyrë, gjini, identitet gjinor, orientim seksual ose për shkak të përkatësisë së tyre me persona që kanë një nga karakteristikat e mbrojtura të lartpërmendura;
- » për kryerjen me dashje të dy ose më shumë vrasjeve, me përjashtim të veprave të parashikuara në nenet 174 dhe 176 të këtij Kodi;
- » nga autori i dënuar më parë për vrasje, me përjashtim të veprave të parashikuara në nenet 174 dhe 176 të këtij Kodi.^[49]

[48] Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

[49] Kodi Penal, neni 173.

Vrasja e kryer në gjendje të rëndë mendore dënohet me burgim nga një deri në 10 vjet, ndërsa për vrasjen nga pakujdesia dënimi i parashikuar është burgimi nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.^[50]

Ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2019 prezantuan një formë të re të vrasjes së rëndë, përkatësisht marrjen e jetës së një personi për shkak të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës, *gjinisë*, *identitetit gjinor*, *orientimit seksual* ose për shkak të lidhjes së tij me persona që kanë një nga karakteristikat e mbrojtura të lartpërmendura. Për rrjedhojë, vepra penale e vrasjes për motive gjinore parashikohet si vrasje e rëndë dhe dënohet me jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.^[51] Megjithatë, nga përkufizimi duket se vrasja me motive gjinore mund të kryhet nga burrat ose gratë kundër burrave ose grave, duke mos përcaktuar në mënyrë konkrete krimin e femicidit. Megjithatë, është e qartë se ky përkufizim përfshin *vrasjen e grave për motive gjinore*, e cila sipas përkufizimeve të njohura përgjithësisht quhet femicid.

Përderisa vrasja me motive gjinore është vrasje e rëndë ose krim i rëndë,^[52] Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatave Themelore ka juridiksion për të vendosur mbi këto çështje dhe këto çështje gjykohen me trup gjykues prej tre gjyqtarësh.^[53]

Në ndryshimet e Kodit Penal të vitit 2019, dhuna në familje^[54] përfshihet dhe përkufizohet si dhunë fizike, psikologjike ose ekonomike ose keqtrajtim me qëllim cenimin e dinjitetit të një personi tjetër në kuadër të një marrëdhënieje në familje. Dënimi i parashikuar është gjobë dhe burgim deri në tre vjet. Është shumë e rëndësishme të nënvizohet se Kodi Penal parashikon që kur një vepër penale kryhet në kuadër të një marrëdhënieje familjare, kjo konsiderohet rrethanë rënduese. Marrëdhënia familjare është ndërmjet personave që janë ose kanë qenë të fejuar, janë ose kanë qenë të martuar, ose janë ose kanë qenë në një bashkësi jashtëmartesore, janë ose bashkëtojnë në një ekonomi të përbashkët; përdorin të njëjtën shtëpi të përbashkët dhe kanë lidhje gjaku, martesë, birësimi, vjehri ose janë në një lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipërit, vëllezërit e motrat, hallat, xhaxhallarët, mbesat, nipërit, kushërinjtë; ose

[50] Kodi Penal, nenet 174 dhe 175.

[51] Kodi Penal, neni 173, paragrafi 1, pika 1.10.

[52] Kodi i Procedurës Penale, nr. 08/L-032, neni 21.

[53] Ligji nr. 06/L-054 Për Gjykatat.

[54] Kodi Penal, neni 248.

personat që janë prindërit e një fëmije të përbashkët.^[55] Duhet theksuar se Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje^[56] rregullon dhënien e masave mbrojtëse dhe parashikon sanksione për shkeljen e tyre, ndërsa Kodi Penal parashikon sanksione për vetë dhunën në familje.

Strategjia Kombëtare e miratuar së fundi për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026^[57] pranon se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkeljes së të drejtave të njeriut dhe se dhuna në familje mbetet një nga format më të përhapura të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe një ndër problemet më të rënda me të cilat përballet shoqëria në Kosovë. Sipas Strategjisë, përparësi është lufta kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore përmes objektivave strategjike të mëposhtëm: marrjes së përgjegjësisë për trajtimin me përparësi të të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore në luftën kundër dhunës së tillë; sigurimit të qasjes në shërbime të integruara cilësore; garantimin e drejtësisë për viktimat dhe të mbijetuarit; sigurimin e riintegritimit dhe fuqizimit të viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; ndëshkimit, risocializimit dhe rehabilitimit të dhunuesve dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin

Të dhënat sasore

Nuk ka asnjë statistikë zyrtare për të dhënat dhe publikimin e të dhënave për femicidin, veçanërisht duke pasur parasysh se femicidi nuk parashikohet shprehimisht si vepër penale më vete. Në bazë të kërkesës, institucionet publike, si Policia e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mund të japin disa të dhëna zyrtare. Megjithatë, këto të dhëna shpesh nuk përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm, dhe ndonjëherë të dhënat nuk përputhen, kështu që nuk janë burim i besueshëm informacioni. Mungesa e statistikave zyrtare për dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe femicidin paraqet pengesë në ndërgjegjësimin dhe në luftën kundër

[55] Kodi Penal, neni 113, para. 25.

[56] Ligji nr. 03/L-182 "Për mbrojtjen e dhunës në familje".

[57] Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, mund ta gjeni në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

këtij fenomeni. Hendeku statistikor në Kosovë reflektohet edhe nga rekomandimet e Sekretariatit të GREVIO-s, sipas të cilit, ndër të tjera, (i) autoritetet në Kosovë duhet të zgjerojnë fushën e të dhënave të mbledhura nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori për të mbuluar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të sigurohet që të dhënat e tilla të klasifikohen sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe dhunuesit; dhe (ii) autoritetet në Kosovë duhet të sigurojnë shtrirjen e të dhënave të mbledhura nga shërbimet sociale dhe strehëzat për të siguruar që ato trajtojnë të gjitha format e dhunës në pajtim me Konventën e Stambollit, duke i ndarë të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënieve viktimë-autor vepre, si dhe kategori të tjera përkatëse si statusi i aftësisë së kufizuar.

Duke pasur parasysh të gjitha kufizimet e lartpërmendura, sipas të dhënave të disponueshme, gjatë periudhës 2018-2022, në Republikën e Kosovës kanë ndodhur njëzet (20) femicide dhe katër (4) tentativa për vrasje femicide. Megjithatë, që nga korriku i vitit 2023, për hulumtim ishin të disponueshme vetëm pesë (5) vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme. Studimi kërkimor^[58] i kryer në vitin 2023 tregon se:

- » të gjitha vrasjet e grave janë kryer nga burrat në kuadrin e marrëdhënieve familjare;
- » tre nga pesë raste janë cilësuar si vrasje e rëndë, privim nga jeta e një familjari, një rast është cilësuar si vrasje e rëndë me qëllim të kryerjes së dy apo më shumë vrasjeve dhe një rast është cilësuar si lëndim i rëndë trupor me pasojë vdekjen;
- » asnjë nga vrasjet nuk është cilësuar si vrasje e rëndë, e motivuar nga shkaqe gjinore;
- » mesatarisht, autorët e veprave janë dënuar me dënim prej njëzet e katër (24) vjet burgim;
- » në disa raste rrethanat lehtësuese nuk janë vlerësuar mirë;
- » nuk është përdorur gjuhë diskriminuese gjinore, viktimat nuk janë fajësuar dhe krimi nuk është justifikuar në asnjë mënyrë në arsyetimin e vendimeve të gjykatave.

Raste studimore

Një përshkrim i shkurtër i praktikës gjyqësore të përzgjedhur jep informacion për dy raste studimore, ndërsa raporti i plotë kombëtar ofron një analizë të detajuar të pesë rasteve të identifikuara.

[58] Do të botohet në dimrin e vitit 2023.

Rasti studimor nr. 1

Autori i veprës qëllloi dhe vrau gruan dhe vajzën e tij, pasi hapi derën e shtëpisë dhe qëllloi menjëherë në drejtim të tyre, me një pushkë të tipit AK-47. Më herët atë ditë, autori me familjarët e tij kanë vizituar viktimën e cila po qëndronte në shtëpinë e kushëririt të saj me fëmijët e saj. Ai donte të pajtohej me të, por ajo nuk pranoi. Më vonë atë ditë, autori i ka dërguar një sërë mesazhesh kërcënuese në telefon dhe ajo e ka denoncuar atë në polici. Ai ka qenë i dhunshëm ndaj saj shumë herë më parë, duke përfshirë edhe incidentin e fundit që ka ndodhur në publik, gjatë një dasme, për të cilën ai u ndalua për 30 ditë. Ai ishte veteran luftime.

Gjatë procesit gjyqësor, ai e pranoi krimin, por pretendoi se i kishte vrarë pa dashje, domethënë donte të vriste vëllain e gruas së tij, duke e konsideruar atë përgjegjës për të gjithë situatën. Gjithashtu, u tha se ai vuan nga stresi post-traumatik (PTSD), për faktin se ishte veteran luftime, i burgosur në Serbi. Familjarët e përshkruan atë si shpeshherë agresiv, të padurueshëm dhe të ndjeshëm, pas vuajtjes së burgut. Megjithatë, ekzaminimi psikiatrik nuk identifikoi ndonjë çrregullim mendor të përkohshëm apo të përhershëm dhe se ai nuk kishte aftësi të zvogëluar për të kontrolluar veprimet e tij në momentin e kryerjes së krimit.

Të dhënat për viktimën janë të pakta në gjykim. Ajo ishte e martuar për shkak të traditës së vjetër të mblesërisë, kishte pesë fëmijë me autorin dhe ishte dhunuar shumë herë fizikisht nga autori.

Autori u akuzua dhe u dënua për vrasje të rëndë (vrasje me dashje e dy ose më shumë personave) dhe për pronësi, kontroll dhe zotërim të paautorizuar të armëve. Gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj të parë e dënoi autorin me 24 vjet burgim. Rrethanat lehtësuese të konstatuara ishin pranimi i fajit dhe ndjenja e pendimit, ndërsa rrethanat rënduese ishin niveli i lartë i përfshirjes në veprën penale dhe niveli i dashjes. Gjykata e Apelit e prishi vendimin dhe e dënoi autorin me burgim të përjetshëm. Ndër të tjera, në vendimi e saj thuhet se nuk janë vlerësuar si duhet rrethanat rënduese, veçanërisht këmbëngulja e autorit për kryerjen e veprës, mënyra e kryerjes së veprës (të shtëna me breshëri nga automatiku), rrezikimi i personave të tjerë të pranishëm në shtëpi, si dhe dhuna e mëparshme ndaj viktimës. Gjykata e Lartë urdhëroi rigjykim për shkak të pranimit të pjesshëm të fajit.

Në rigjykim, Gjykata Themelore në thelb deklaroi të njëjtën gjë si në vendimin e parë dhe përsëri e dënoi autorin me 24 vjet burgim. Kësaj radhe rrethanat lehtësuese përfshinin gjendjen ekonomike, moshën, sjelljen e duhur para

gjykatës dhe pendimin e shprehur. Rrethanat rënduese përfshijnë dënimet e tij të mëparshme për dhunë ndaj viktimës dhe mënyrën e kryerjes së krimit. Në vendimin e dytë të Gjykatës së Apelit, autori u shpall fajtor për vrasje të rëndë të dy apo më shumë personave dhe pronësi, kontroll dhe zotërim të paautorizuar të armëve dhe u dënua me një dënim të unifikuar me tridhjetë (30) vjet burgim. Përsëri, Gjykata e Apelit deklaroi se rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk janë vlerësuar mirë nga Gjykata Themelore, veçanërisht fakti se autori ka qenë i dhunshëm ndaj viktimës më parë, se krimi është kryer në shtëpinë e familjes së viktimës ku ajo ndodhej. duke u fshehur me fëmijët e saj, se krimi është kryer në prani të familjarëve të viktimës, se ai ka vrarë edhe vajzën e tij të mitur, si dhe se autori ka treguar vendosmëri dhe këmbëngulje të fortë për të kryer krimin.

Komente

Në kohën e kryerjes së femicideve (2018), vrasja e rëndë e motivuar për shkaqe gjinore ende nuk ishte parashikuar si krim në Kodin Penal. Për këtë arsye, gjykatat e cilësuan këtë vepër si vrasje të rëndë, përkatësisht si vrasje me dashje e dy ose më shumë personave. Nga momenti i ngritjes së aktakuzës deri në vendimin e formës së prerë kaluan 2.5 vjet, periudhë e cila plotëson kriteret për të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në arsyetimin e të gjitha vendimeve nuk është përdorur asnjë gjuhë seksiste apo degraduese ndaj viktimave. Megjithatë, trajtimi i procedurës nga Gjykata Themelore meriton vëmendje të veçantë. Kjo ishte një nga format tipike të femicideve, rasti në të cilin një dhunë e gjatë në familje përfundon në një femicid. Gjykata Themelore nuk e ka marrë parasysh këtë fakt siç duhet. Po ashtu, pas vendimit të parë të Gjykatës së Apelit, ku kjo gjykatë e shkallës së dytë ka dhënë disa komente lidhur me arsyetimin e vendimit të shkallës së parë, duket se Gjykata Themelore gjatë rigjykitimit nuk i ka kushtuar vëmendje udhëzimit dhe arsyetimit të Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, Gjykata Themelore i vlerësoi si lehtësuese edhe rrethanat në vijim: gjendjen ekonomike të autorit, moshën e tij dhe sjelljen e duhur para gjykatës. Asnjë nga rrethanat e përmendura nuk duhet të konsiderohet si lehtësuese në këtë rast. Statusi ekonomik nuk është i rëndësishëm për femicidin. I njëjti përfundim mund të nxirret në lidhje me moshën e autorit, e cila është krejtësisht e parëndësishme. Së fundi, sjellja e duhur para gjykatës është diçka që duhet të jetë një tipar standard në çdo gjykim, dhe në rastet kur një autor nuk sillet siç duhet para gjykatës, gjyqtari ka mundësi të ndryshme procedurale (p.sh. të ndëshkojë autorin, etj.).

Duhet theksuar se Gjykata e Apelit e ka pranuar vlerësimin e Gjykatës Themelore lidhur me rrethanat lehtësuese, edhe pse ka pasur mundësi ta korrigjojë atë. Nga ana tjetër, as rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar mirë. Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar këto rrethana rënduese, të cilat nuk janë përfshirë në vendimin e Gjykatës Themelore: dhunën e mëparshme në familje të autorit të veprës ndaj viktimës; faktin që krimi është kryer në shtëpinë e familjes së viktimës në sy të nënës, vëllezërve dhe fëmijëve të saj; faktin që autori kishte vrarë vajzën e tij të mitur; faktin që viktimat me asnjë veprim nuk kanë kontribuar në veprën penale; dhe përcaktimin e autorit për kryerjen e veprës penale. Megjithatë, nuk është e qartë se përse Gjykata e Apelit në vendimin e dytë ka vendosur dënimin e autorit me 30 vjet burgim, duke pasur parasysh se ai është dënuar me burgim të përjetshëm me vendimin e parë të Gjykatës së Apelit.

Rasti studimor nr. 2

Pas një shërbimi të mëparshëm me bashkëshorten, autori i veprës e ka vrarë viktimën me pistoletë të tipit Beretta teksa po dilte nga shtëpia, duke qëlluar me 15 plumba në drejtim të saj. Një dëshmitar dëshmoi se pas të shtënave autori i është afruar viktimës dhe i ka thënë “kurvë”. Gjithashtu, autori ka telefonuar motrën e viktimës dhe i ka thënë ftohtë “E vrava, ajo vdiq”. Sipas vajzave të viktimës, marrëdhënia mes çiftit ka qenë e mirë deri dy javë para vrasjes, kur viktima kishte *vënë re se autori* kishte ndryshuar sjellje, pra ishte sjellë në mënyrë kontrolluese dhe ishte *bërë agresiv*. Ditën e vrasjes, viktima u kishte thënë vajzave të saj se autori e kishte rrahur dhe e kishte kërcënuar me armë. Autori punonte si taksist, i përkiste një klase të mesme ekonomike, kishte qenë më parë i divorcuar dhe baba i tre fëmijëve. Ekzaminimi mjekësor arriti në përfundimin se në momentin e vrasjes ai ishte i aftë mendërisht dhe i shëndoshë. Viktima ishte e ve dhe i rriste e vetme vajzat e saj. Më pas ajo u martua me dhunuesin dhe ata u shpërngulën në Zvicër, por ajo nuk ishte e lumtur atje dhe donte të kthehej në Kosovë. Gjatë gjykimit, autori argumentoi se nuk e vrau me dashje viktimën, se ata jetonin në harmoni dhe pa dhunë dhe se sjellja e saj e paarsyeshme natën kritike i provokoi në mendje “ndjenja të papërshtueshme zemërimi dhe ankthi”.

Vepra është cilësuar si vrasje e rëndë, vrasje e familjarit në lidhje me pronësi, kontroll dhe zotërim të paautorizuar të armëve, ndërsa Gjykata Themelore e ka dënuar me burgim të përjetshëm autorin. Gjykata Themelore nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë lehtësuese, ndërkohë që ka pasur shumë rrethana rënduese, të cilat janë shumë mirë të shtjelluara. Disa nga rrethanat rënduese ishin: rreziku shoqëror i shkaktuar nga autori (15 të shtëna prej tij); shkalla e përgjegjësisë penale (paramendim, fyerje); pasojat e veprës penale; mënyra tizare

e kryerjes së krimit; sjellja e tij pas aktit (qëndrimi gjakftohtë; thirrja e familjes së viktimës); mostregimi i pendimit gjatë gjykimit për aktin kundër viktimës, por shprehja e ndjenjës së keqardhjes për veten; qëndrimi i tij jo i duhur ndaj vajzave të viktimës dhe intensiteti i dhimbjes emocionale të vajzave të viktimës. Gjykata e Apelit e ka ndryshuar pjesërisht këtë vendim dhe e ka dënuar autorin me 25 vite burgim. Gjykata e Apelit konstatoi se kishte rrethana lehtësuese që gjykata e shkallës së parë nuk i kishte marrë parasysh. Për shembull, se autori është baba i tre fëmijëve, se është relativisht i vjetër, se ka shprehur keqardhjen dhe i ka kërkuar falje dy vajzave të viktimës, ka kërkuar falje publike (gjatë seancës gjyqësore) dhe nuk është dënua më parë. Sa i përket rrethanave rënduese, Gjykata e Apelit ka deklaruar se disa nga rrethanat rënduese në fakt kanë qenë lehtësuese, veçanërisht sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës (ka marrë një shall të viktimës dhe ka mbuluar kufomën). Gjithashtu, thuhet se vrasja nuk është kryer në mënyrë tinëzare dhe se fakti që ai ka telefonuar familjen e viktimës nuk duhet konsideruar si rrethanë rënduese, por thjesht një fakt i informimit të familjes së saj.

Komente

Ky rast femicidi u cilësua si vrasje e rëndë e një familjari, por mund të cilësohej edhe si vrasje e rëndë për shkak të gjininë dhe më pas fakti që viktima ishte familjar do të konsiderohej si rrethanë rënduese, sipas dispozitave të Kodit Penal. Sanksioni i vendosur nga Gjykata e Apelit është shumë i butë dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk janë shtjelluar mirë. Gjykata e Apelit e ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin se ai është baba i tre fëmijëve, që sipas nesh mund të vlerësohet vetëm si rrethanë rënduese, duke pasur parasysh faktin se ka vrarë bashkëshorten, d.m.th. ka kryer një vrasje në kontekstin familjar. Për më tepër, mosha e tij relativisht e vjetër është krejtësisht e parëndësishme për vlerësimin e fajësisë së individit. Fakti që ai nuk ka qenë i dënua më parë, edhe pse zakonisht përdoret si rrethanë lehtësuese, sipas nesh nuk është për t'u konsideruar si rrethanë lehtësuese, sepse shumica e popullsisë nuk është dënua më parë. Prandaj, ndërsa dënimet e mëparshme mund të vlerësohen si rrethanë rënduese, mungesa e dënimeve të mëparshme nuk është rrethanë lehtësuese. Gjithashtu, pendimi i tij dhe kërkimi i faljes publike gjatë seancës së gjykatës mund të konsiderohen si përpjekje e tij për të ulur nivelin e përgjegjësisë dhe përpjekje për ta portretizuar veten si një person të mirë. Në fund, Gjykata e Apelit nuk shpjegoi arsyen që qëndron pas vendimit të saj për të mos trajtuar këtë femicid si të kryer në mënyrë tinëzare, duke pasur parasysh se autori e qëllloi viktimën 15 herë duke përdorur një armë të mbajtur pa leje.

MALI I ZI

Kuadri ligjor

Kodi Penal i Malit të Zi nuk e parashikon shprehimisht si veprë penale femicidin. Megjithatë, si në shtetet e tjera të rajonit, disa lloje të vrasjeve janë të parashikuara si vepra penale. Forma bazë është vrasja, një veprë kundër jetës si objekt mbrojtjeje (përveç kësaj, kërcënimi i integritetit fizik të njeriut). Këto janë krimet e mëposhtme kundër jetës:

- » vrasja (neni 143 i KP-së);
- » vrasje e rëndë (neni 144 i KP-së);
- » vrasje në një çast (në valë pasioni) (neni 145 i KP-së);
- » vrasja e fëmijës gjatë lindjes (neni 146 i KP-së);
- » privimi nga jeta për shkak të dhembshurisë (vrasja për mëshirë) (neni 147 i KP-së);
- » privimi i jetës nga pakujdesia (neni 148 i KP-së)

Forma themelore e vrasjes konsiston në heqjen e paligjshme nga jeta të një personi tjetër, kur nuk ekzistojnë rrethana të veçanta që e bëjnë atë të rënduar apo të privilegjuar. Objekti i mbrojtjes në këtë veprë penale është jeta e njeriut ose e drejta për jetë, si një nga të drejtat themelore të njeriut.

Autori i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe, përsa i përket fajit, kërkohet dashja. Vepra penale kryhet me dashje kur autori ka qenë në dijeni të veprës së tij dhe ka dashur ta kryejë atë, ose kur autori ka qenë i vetëdijshëm se mund ta kryejë veprën dhe ka dhënë pëlqimin për kryerjen e saj (neni 15 i KP-së). Për këtë veprë penale Kodi Penal parashikon dënim me burg nga 5 deri në 15 vjet.

Vrasja e rëndë ekziston kur vrasja kryhet në atë mënyrë, në rrethana të tilla ose kundër një personi të tillë që i japin asaj një shkallë më të rëndë dhe rrezikshmërie për të cilën ligji parashikon një dënim më të ashpër. Vrasjet e rënda janë vrasje me paramendim (të kryera me paramendim keqdashës). Qëllimi i autorit duhet të përfshijë si privimin e jetës së një personi tjetër, ashtu edhe rrethanën rënduese që e bën vrasjen të kryhet në rrethana rënduese. Ka disa forma të vrasjes së rëndë, të cilat ndryshojnë sipas: mënyrës së kryerjes, motivit të autorit, rrethanave të kryerjes dhe pasojave dhe karakteristikave të subjektit pasiv. Autor i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për veprën penale të vrasjes së rëndë parashihet dënim me burgim për të paktën 10 vjet ose me burgim afatgjatë kur personi:

- » privon nga jeta një person tjetër në mënyrë mizore ose tinëzare;
- » privon nga jeta një person tjetër me sjellje të dhunshme të pamatur;
- » privon nga jeta një person tjetër dhe në të njëjtën kohë rrezikon jetën e një personi tjetër;
- » i merr jetën një personi tjetër për shkak të lakmisë, me qëllim kryerjen ose fshehjen e një vepre tjetër kriminale, për hakmarrje të pamatur ose për motive të tjera të ulëta;
- » i merr jetën një zyrtari ose ushtaraku gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ose në lidhje me kryerjen e detyrës zyrtare;
- » i merr jetën një fëmije ose një gruaje shtatzënë;
- » i merr jetën një anëtar të familjes ose komunitetit të tij familjar, të cilin e ka abuzuar më parë;
- » me dashje i merr jetën disa njerëzve, duke siguruar që nuk është fjala për vrasje, vrasje të një fëmije gjatë lindjes ose marrjen e jetës nga dhembshuria (vrasja për mëshirë).

Dënimi me burgim afatgjatë nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 vjet e as më i gjatë se 40 vjet.

Gjithashtu, Kodi Penal i Malit të Zi parashikon veprën penale të dhunës në familje me pasojë vdekjen e një anëtar të familjes ose anëtarit të bashkësisë familjare (neni 220, paragrafi 4), si formë të veçantë të rëndë të veprës penale të dhunës në familje.

Sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga dhuna në familje”,^[59] dhuna në familje është veprimi ose mosveprimi i një anëtar të familjes që rrezikon integritetin fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik, shëndetin mendor dhe qetësinë e një anëtar tjetër të familjes, pavarësisht vendit ku kryhet akti. Ky ligj nuk përcakton dhunën ndaj grave, por jep vetëm një përkufizim të përgjithshëm të konceptit të dhunës në familje. Ligji parashikon disa lloje të masave mbrojtëse që mund të zbatohen ndaj autorit të dhunës.

Ekziston problemi i cilësimit ligjor të veprës së dhunës në familje, më konkretisht marrjes së vendimit nëse veprat e dhunës në familje duhet të ndiqen si kundërvajtje,

[59] Ligji “Për mbrojtjen nga dhuna në familje”, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 046/10, datë 06.08.2010 dhe 040/11, datë 08.08.2011.

në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen nga dhunës në familje”, apo si vepër penale në përputhje me Kodin Penal. Në këtë mënyrë cenohet siguria juridike sepse është e pamundur të parashikohen me siguri pasojat e një akti në bazë të përcaktimeve ligjore. Është shumë e rëndësishme që kuadri ligjor malazez të bëjë dallimin e qartë ndërmjet përgjegjësive jo penale dhe penale në rast të dhunës në familje.

Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin

Hulumtimi mbi përgjigjen sociale dhe institucionale ndaj femicideve në Mal të Zi është kryer nga SOS Nikshiq.^[60] Raporti kombëtar përmban një analizë të thelluar të analizës gjyqësore.

Të dhënat cilësore

Në periudhën janar 2015 deri në dhjetor 2019, Gjykata e Lartë në Podgoricë dhe Gjykata e Lartë në Bijelo Polje kanë dhënë vendime të formës së prerë për 10 çështje gjyqësore. Gjashtë prej tyre konsiderohen si femicide, pra si vrasje apo tentativa për vrasje të një gruaje nga një burrë. Në të gjitha rastet e femicideve dhe tentativave për femicide, autori dhe viktima kanë qenë në marrëdhënie martesore, emocionale ose familjare (bashkëshorti/ish-bashkëshorti, partneri intim, djali, nipi).

Profili i autorëve të veprave

Shumica e autorëve nuk kanë pasur dënime të mëparshme penale. Autorët në përgjithësi nuk pranuan se e kishin kryer krimin. Në të gjitha rastet e analizuara gjyqësore janë gjetur disa ngjashmëri, por në përgjithësi mungojnë të dhënat për anamnezën familjare dhe personale të autorëve dhe nuk dihet nëse autorët kanë pasur varësi nga alkooli apo droga në periudhën para kryerjes së femicidit, sepse këto fakte nuk përshkruhen në vendime.

Autorët kanë treguar brutalitet të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve ndaj grave, ndërkohë që kanë qëndruar gjakftohtë, janë sjellë normalisht ose janë larguar nga vendi i ngjarjes pas vrasjes. Ata përdorën forcë fizike (goditje, mbytje dhe mbytje), mjete të ndryshme (çekiç, lugë metalike, etj.), armë të ftohta (thikë), si dhe armë zjarri (pistoletë, pushkë, bombë dhe mjet shpërthyes).

[60] Beker Kosana (ed.), Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Crnoj Gori, SOS Nikšić, Nikšić, 2023, mund ta gjeni në: <https://sosnk.org/wp-content/uploads/2023/04/Drustveni-i-institucionalni-odgovor-na-femicid-u-Crnoj-Gori-1.pdf>

Profili i viktimave

Në gjashtë raste kishte shtatë viktimat të femicideve/tentativave për femicide. **Vendimet përmbajnë shumë pak ose aspak informacion për viktimat.** Në shumicën e rasteve, nuk ka informacion për nivelin arsimor të viktimës, vendin e lindjes, numrin e fëmijëve, punësimin ose informacione të tjera të rëndësishme. Sipas të dhënave të disponueshme, gjysma e viktimave ishin të moshës së moshuar (tre viktimat ishin mbi 65 vjeç), dy viktimat ishin të moshës 40-65 vjeç dhe një e moshës 18-30 vjeç.

Marrëdhënia mes autorëve dhe viktimave përpara femicidit ishte përgjithësisht shumë e vështirë dhe problematike. Ndërmjet viktimave, janë të pakta ato që kanë raportuar dhunën dhe nuk kanë marrë mbrojtje efektive, e cila do të parandalonte dhunën e mëtejshme dhe vrasjen ose tentativën për vrasje.

Motivi i veprës penale në një rast është shprehur konkretisht nga gjykata, sipas së cilës autori i ka vënë emocionet e tij para jetës së saj, është udhëhequr nga egoizmi dhe dëshira që viktimat t'i përkiste vetëm atij dhe duke qenë se ajo nuk e pranoi, ai e mori asaj jetës. Në dy raste kur autorët vranë bashkëshortet me të cilat ishin në proces divorci, shkak i menjëhershëm i krimit sipas deklarimeve të autorëve ishte dëshira për të parë fëmijët e tyre. E zakonshme në të dyja rastet është periudha shumëvjeçare e dhunës brutale që autorët kishin ushtruar ndaj viktimave dhe fëmijëve. Autorët ishin zemëruar sepse kishin humbur kontrollin mbi viktimat dhe fëmijët.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Me rastin e vlerësimit të llojit dhe peshës së sanksionit penal, gjykata kompetente jo gjithmonë i ka vlerësuar në mënyrë të përshtatshme rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Për më tepër, ato janë renditur shumë përgjithësisht dhe gjerësisht. Si rrethana lehtësuese gjykata ka konsideruar: faktin se autori nuk kishte pasur dënime të mëparshme; kishte probleme personale shëndetësore, përkatësisht faktin se gjatë procesit gjyqësor ndërsa ishte i ndaluar në pritje të gjykimit, autori kishte pësuar goditje në tru që kishte shkaktuar një *sindromë psiko-organike*; faktin se ai e kishte kryer veprën në gjendje të aftësisë mendore të zvogëluar dukshëm.

Si rrethana rënduese, vendimet renditnin: lidhjen e gjakut mes autorit dhe viktimës; faktin që viktimat ishin të vetmi person që ishte kujdesur për autorin dhe e kishte mbështetur financiarisht atë; faktin se viktimat ishin një person i moshuar (78 vjeç), dhe dënimet e mëparshme të autorit, ndër të tjera, për krime të dhunshme.

Sa i përket sanksioneve, në dy raste gjykata i ka dënuar autorët me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor. Në një rast autori është dënuar me 20 vjet burgim dhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Në një rast autori është dënuar me 19 vjet burg, ndërsa në një rast tjetër autori është dënuar me 20 vjet burgim. Në rastin e fundit, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata ka dhënë dënimin me burg prej 2 vjet e 10 muaj.

U vu re se gjykatat rrallë shpjegojnë dimensionin gjinor të rasteve, dhunën e mëparshme dhe raportet ndërmjet palëve. Në një nga rastet, gjykata nuk ka deklaruar askund se viktimja ka qenë viktimë e dhunës në familje për shumë vite para se të kryhej krimi, madje edhe menjëherë para kryerjes së krimit të vrasjes. Ekzistenca e dhunës në familje konstatohet nga dëshmitë e dëshmitarëve, por gjykata nuk është thëlluar në marrëdhëniet mes dhunuesit dhe viktimës, çfarë do të thotë se nuk është marrë parasysh dimensionin gjinor i veprës penale të kryer.

Raste studimore

Një përshkrim i shkurtër i rasteve të përzgjedhura jep disa informacione të rëndësishme për dy raste, ndërsa raporti i plotë për Malin e Zi jep analizë të detajuar për të pesta rastet.

Rasti studimor nr. 1

Në vitin 2018, S.E. akuzohej për veprën penale të vrasjes së rëndë. Gjykata në vendim ka theksuar se autori me dashje dhe në mënyrë mizore i ka privuar P.D.-së jetën së saj, edhe pse ai ishte në dijeni të ndalimit të veprimeve të tij. Ai e kreu krimin duke shkuar në banesën e saj, duke e goditur vazhdimisht me sende të mprehta dhe me duar, pas së cilës i ka mbajtur hundën dhe gojën mbyllur dhe i ka shtypur gjunjët në gjoks, gjë që ka sjellë mbytjen e viktimës.

Gjykata e dënoi autorin me 20 vjet burgim dhe ndaj tij caktoi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor.

Autori S.E. jetonte në të njëjtin qytet me viktimën; kishte mbaruar shkollën e mesme ekonomike, ishte i papunë, i pamartuar, pa fëmijë, me nivel ekonomik mesatar, i pa dënuar. Të paktën pesë vjet para se të kryhej krimi, ai kishte marrëdhënie të këqija me shumicën e anëtarëve të familjes së tij. Ai kontaktonte rrallë prindërit e tij. Ai prej vitesh nuk donte të kishte asnjë kontakt me nënën e tij. Ai shpesh kërkonte para hua nga anëtarët e familjes së tij të ngushtë dhe të gjerë, kështu që shumica e tyre ishin distancuar prej tij. I vetmi familjar që i ka

qëndruar gjatë gjithë kohës pranë ishte tezja e tij, të cilën ai e ka vuarë. Asaj i vinte keq, shpesh i jepte para, i thoshte se duhet të gjente një punë dhe në disa raste i kishte kërkuar familjes së tij “të bënte diçka dhe ta ndihmonte, por kjo kërkesë e saj nuk gjeti mirëkuptim nga familja e tij”. Sipas mendimit të ekspertit thuhet se ai është person me kapacitet intelektual në nivelin mesatar. Autori nuk bëri mbrojtjen e tij gjatë procesit gjyqësor. Ai nuk e pranoi kryerjen e veprës penale dhe deklaroi se “në rastin konkret është një proces gjyqësor i inskenuar, kështu që [ai] nuk dëshiron të thotë asgjë”.

Viktima ishte tezja e autorit. Ajo ishte 78 vjeç, jetonte e vetme në qytet në banesën e saj. Ajo ishte pensioniste me një pension të lartë për standardet malazeze dhe ndihmohej financiarisht nga vajza e saj, e cila jetonte jashtë vendit. Ajo ishte në gjendje të mirë shëndetësore për moshën që kishte. Ajo kishte lidhje të mira familjare dhe shoqërore. Ajo ishte i vetmi person që vazhdimisht i jepte ndihmë dhe mbështetje autorit. Një herë ajo e denoncoi autorin në polici, por kur punonjësit e policisë e pyetën nëse donte ta vazhdonte denoncimin për shkak të dhunës së ushtruar ndaj saj, ajo u përgjigj me jo sepse “i vinte keq” për autorin. Për një periudhë të caktuar kohe para se të vritej, ajo u kishte thënë njerëzve që kishin shkuar për ta vizituar se familja e saj kishte probleme me S.E.

Gjykata mori parasysh se autori nuk ishte dënuar më parë, rrethanat personale, domethënë faktin se gjatë procesit gjyqësor, derisa ndodhej në një institucion shëndetësor, ka pësuar një “goditje në tru që ka sjellë sindromën psiko-organike”, si dhe ai e kishte kryer aktin në një gjendje mendore të zvogëluar ndjeshëm të shkaktuar nga çrregullimi i personalitetit të skajshëm “i cili përbën një çrregullim mendor më të rëndë”. Si rrethana rënduese gjykata ka konsideruar lidhjen e gjakut të autorit me viktimën, faktin se ajo ishte i vetmi person që kujdesej për të dhe e ndihmonte financiarisht dhe se ishte një person i moshuar.

Komente

Gjykata në përgjithësi nuk u angazhua për shqyrtimin dhe analizën e detajuar të marrëdhënies së mëparshme ndërmjet autorit dhe viktimës dhe dhunës që ai kishte kryer më parë ndaj viktimës dhe as nuk mori parasysh dimensionet gjinore të qarta të krimit të kryer.

Fakti që viktima refuzoi të denonconte për dhunën në familje mund të shpjegohet me frikën e saj nga dhunuesi, por edhe me qasjen patriarkale se autori është i afërm i saj dhe se çdo problem, qoftë edhe dhuna e dukshme psikologjike, duhet të mbetet brenda familjes. Mosbesimi në institucione mund të jetë shkak për tërheqjen e denoncimit të bërë për dhunë. Është e qartë se organet kompetente nuk kanë reaguar në mënyrë të përshtatshme dhe nuk kanë arritur të njohin rreziqet e vrasjes.

Rasti studimor nr. 2

Në një rast tjetër të analizuar të tentativës së vrasjes, ku prokurori i shtetit dhe autori kanë lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, gjykata e ka pranuar atë dhe e ka dënuar autorin me burgim prej dy vjet e 10 muaj.

Sipas të dhënave të çështjes, R.E. ka goditur me thikë A.E pas një restoranti. Ajo ka marrë lëndime të rënda fizike, të cilat i kanë sjellë vdekjen. Nuk ka të dhëna për marrëdhëniet mes autorit dhe viktimës. Nga shkresat e lëndës shihet se R.E. e ka planifikuar dhe e ka kryer veprën me dashje (paramendim keqdashës).

R.E. ka mbaruar shkollën fillore dhe punonte si shitës në treg, ishte i martuar, pa fëmijë dhe siç pohoi vetë, kishte gjendje ekonomike mesatar. Pesë vite para vrasjes në tentativë, autori është dënuar për veprën penale të kanosjes me armë të rrezikshme dhe është dënuar me gjobë prej 400 eurosh. Dokumentacioni i çështjes nuk përmban të dhëna për viktimën, përveç se ajo ishte femër.

Komente

Në këtë rast është zbatuar instrumenti i marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Ky instrument i vë viktimat e dhunës në një pozitë të palakmueshme, duke qenë se nuk kërkohet pëlqimi i tyre për të lidhur një marrëveshje të tillë. Ne mendojmë se një zgjidhje e tillë ligjore nuk është e përshtatshme dhe se, sipas zgjidhjeve në të drejtën krahasuese, për disa kategori të veprave penale, të tilla si krimet kundër jetës dhe gjymtyrëve, dhe ato që kanë të bëjnë me lirinë seksuale, por edhe aktet e tjera të dhunës me bazë gjinore, do të ishte e nevojshme të parashikohej një detyrim i prokurorit për të marrë pëlqimin e viktimës, nëse vendoset të përdoret ky instrument juridik. Në

rastet e femicideve, pëlqimi për lidhjen e marrëveshjes duhet të jepet nga të dëmtuarit, pasi kjo respekton interesin legjitim të viktimës së veprës penale që procesi gjyqësor të ketë një përfundim të drejtë. Ne gjithashtu besojmë se është e nevojshme të parashikohet mundësia që viktima, përkatësisht pala e dëmtuar, të paraqesë ankesë nëse vendimi bëhet në bazë të një marrëveshjeje e cila nuk aprovet nga viktima/pala e dëmtuar, ose nëse vendimi nuk është në përputhje me marrëveshjen e lidhur.

Në hulumtimet e kemi konsideruar këtë rast si femicid, edhe pse për shkak të gjendjes mendore të autorit nuk ka qenë e mundur të vërtetohet motivi i kryerjes së veprës penale. Ndërkohë vendimi nuk ka dhënë informacione për shkak se vendime të tilla të bazuara në marrëveshje për pranimin e fajësisë nuk përmbajnë hollësi lidhur me informacione për rrethanat në lidhje me mënyrën e kryerjes së krimit, jetën e mëparshme të të pandehurit dhe marrëdhënien e tij me viktimën. Dënimi me burg prej dy vjet e 10 muaj është qartazi i pamjaftueshëm për veprën penale të kryerjes së vrasjes së mbetur në tentativë. Sipas parashikimit në Kodin Penal, autori mund të dënohet me burgim nga pesë deri në 15 vjet ose me një dënim më të butë. Një dënim i tillë i butë, si një nga elementet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, nuk përkon me qëllimin e dhënies së masave të dënimeve penale, dhe për këtë arsye gjykata duhet ta kishte refuzuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

MAQEDONIA E VERIUT

Kuadri ligjor

Maqedonia e Veriut është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor që e ka parashikuar me ligj femicidin si vepër penale me ndryshimet e Kodit Penal^[61] në mars të vitit 2023, i cili do të prezantohet më vonë në tekst. Teksti bazë i Kodit Penal, i cili deri tani ka pësuar ndryshime të shumta, në nenin 122 përcakton kuptimin e shprehjeve dhe termave që përdoren në të.

[61] Kodi Penal, *Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* nr. 37/96; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, *Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* nr. 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017, 248/2018 dhe *Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* nr. 36/2023.

Për shembull, *dhuna në familje* nënkupton ngacmim, fyerje, kërcënim për sigurinë, lëndim fizik, dhunë seksuale ose tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike që shkakton një ndjenjë pasigurie, kërcërimi ose frike, duke përfshirë kërcënimet për veprime të tilla kundër bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve, ose persona të tjerë që jetojnë në një lidhje martesore ose jashtëmartesore (bashkëjetesë), ose familje të përbashkët, si dhe kundër bashkëshortit aktual dhe ish-bashkëshortit, partnerit jashtëmartesor (bashkëjetuesit), ose personave që kanë një fëmijë të përbashkët ose janë në një marrëdhënie të ngushtë personale, pavarësisht nëse autori ka aktualisht apo ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën apo jo; ^[62] *viktimë e një krimi është*: çdo person i cili ka pësuar dëme, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje materiale ose lëndime të tjera ose kërcënime të lirive dhe të drejtave të tij themelore si rezultat i një krimi të kryer; një fëmijë si viktimë e një krimi; një i mitur nën moshën 18 vjeç; *viktimë e dhunës me bazë gjinore* është çdo grua dhe vajzë nën moshën 18 vjeçare ndaj të cilave është kryer krimi në ato rrethana; ^[63] *familje* nënkupton bashkëshortin, partnerin sipas të drejtës zakonore (bashkëjetuesin), fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe të afërmit e tjerë me të cilët personi jeton në një bërthamë familjare; ^[64] *dhuna me bazë gjinore* ndaj grave është dhunë e drejtuar ndaj grave për shkak të gjinisë së tyre që çon ose mund të çojë në lëndime fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe frikësimin për akte të tilla, detyrimin ose privimi arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse ato ndodhin në jetën publike apo private.^[65]

Krimi i vrasjes^[66] përkufizohet duke përdorur shprehjen *kushdo që privon nga jeta një person tjetër* dhe dënimi i parashikuar është të paktën me pesë vjet burgim. Edhe pse përkufizimi i formës themelore të vrasjes duket i thjeshtë, ai tregon kompleksitetin e krimit kur trajtohen format e ndryshme të vrasjeve të rënda dhe të privileguara. Kur gjykata del me vendim dënimi për të pandehurin për veprën penale të vrasjes, në mënyrë të pashmangshme përcaktohen dhe peshohen elementët e veçantë që përbëjnë thelbin e veprës penale, përveç marrjes parasysh të elementeve të përgjithshme të krimit. Këto elemente të veçanta mund t'i referohen mënyrës së kryerjes së krimit, karakteristikave të viktimës, rrethanave subjektive dhe rrethanave të tjera të parashikuara me ligj dhe rregullojnë përcaktimin e përgjegjësisë individuale.

[62] Pika 21.

[63] Pika 22.

[64] Pika 23.

[65] Pika 43.

[66] Neni 123, paragrafi 1 i Kodit Penal.

Forma e rëndë e vrasjes është privimi me dashje i jetës së një personi tjetër kryer në rrethana veçanërisht rënduese të përcaktuara me ligj, të cilat rrisin ashpërsinë e veprës dhe shkallën e fajësisë së autorit, kështu që ligji parashikon një dënim më të ashpër për vepra të tilla. Kjo lloj vrasjeje ndryshon nga një vrasje e zakonshme për shkak të rrethanave të caktuara rënduese të natyrës objektive ose subjektive, të tilla si mënyra e kryerjes së krimit, karakteristikat e viktimës, motivet e autorit, etj.

Format rënduese të vrasjes^[67] dënohen me burgim për të paktën 10 vjet ose me burgim të përjetshëm dhe përkufizohen si:

- » privimi nga jeta i një personi tjetër gjatë ushtrimit të dhunës në familje;
- » privimi nga jeta i një personi tjetër, në mënyrë mizore ose tinëzare;
- » **privimi nga jeta i një gruaje ose një vajze deri në 18 vjeç, gjatë kryerjes së dhunës me bazë gjinore;**
- » privimi nga jeta e një personi tjetër duke rrezikuar me dashje jetën e një personi tjetër;
- » privimi nga jeta i një personi tjetër për shkak të lakmisë, me qëllim kryerjen ose fshehjen e një krimi tjetër, për hakmarrje të pashpirt, për urrejtje ose për motive të tjera të ulëta;
- » privimi nga jeta i një personi tjetër me urdhër [vrasje me porosi];
- » privimi nga jeta e një personi me qëllim heqjen e një organi, indi ose qelizash për transplantim;
- » privimi nga jeta e një gruaje e cila dihet se është shtatzënë ose e një fëmije;
- » privimi nga jeta e gjyqtarit ose prokurorit publik, gjatë kryerjes së funksionit, përkatësisht veprimtarisë së avokatit, mjekut të mjekësisë ose punonjësit tjetër shëndetësor, gazetarit ose punonjësit tjetër të medias ose një personi tjetër që kryen një punë me interes publik në ushtrimin e detyrave të profesionit ose në lidhje me ushtrimin e detyrave profesionale të ndërmarra në kuadër të kompetencave të tyre ose nga një zyrtar ose nëpunës gjatë kryerjes së detyrave të tij/saj të sigurisë publike ose shtetërore ose detyrës së ruajtjes së rendit publik, gjatë kapjes së autorit të një krim ose ruajtjes së një personi të privuar nga liria.

Sipas paragrafit 3 të të njëjtit nen, kushdo që me dashje privon nga jeta dy ose më shumë persona, dhe nuk është gjykuar më herët për këto krime, dënohet me të paktën me 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

[67] Neni 123, paragrafi 2 i Kodit Penal.

Që **krimi i vrasjes të cilësohet si vrasje e kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje**, duhet të plotësohen dy kushte.

- » duhet të ketë një marrëdhënie objektive ndërmjet dhunuesit dhe viktimës që plotëson elementet e dhunës në familje;
- » duhet të ketë vetëdije se vepra po kryhet në kushte dhune dhe vullneti subjektiv për marrjen e jetës duhet të jetë shprehje e qëndrimit të dhunshëm ndaj viktimës.

Ndryshimet në Kodin Penal të marsit të vitit 2023 prezantuan veprën të femicidit për herë të parë (edhe pse nuk emërtohet si femicide). Përkufizimi i kësaj vepre është si më poshtë: **privimi nga jeta e një gruaje ose një vajze deri në moshën 18 vjeç, gjatë kryerjes së dhunës me bazë gjinore**. Duke pasur parasysh se ndryshimet e ligjit janë bërë së fundi, ende nuk dihet se si do të zhvillohet praktika gjyqësore. Megjithatë, ky është një progres i madh në drejtim të unifikimit të përgjigjes gjyqësor ndaj femicideve.

Vrasjet e rënda janë:

- » vrasje për motive fisnike; ^[68]
- » vrasje në çast (ndryshimet e vitit 2023 shtuan në këtë kategori edhe dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore); vrasje pasioni (ndryshimet e vitit 2023 shtuan edhe vrasjen për shkak të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të kryer nga personi i vrarë) ^[69]
- » vrasje nga pakujdesia; ^[70]
- » vrasja e një fëmije gjatë lindjes; ^[71]
- » nxitja e vetëvrasjes dhe ndihma për vetëvrasje; ^[72]
- » ndërprerja e paligjshme e shtatzënisë dhe sterilizimi i detyruar; ^[73]

Gjithashtu, disa vepra penale të parashikuara në Kodin Penal konsiderohen të rënduara dhe dënohen me sanksione më të ashpra në rast se kryhen në rastet e dhunës me bazë gjinore, dhunës ndaj grave, dhunës në familje ose për

[68] Neni 124 i Kodit Penal.

[69] Neni 125 i Kodit Penal.

[70] Neni 126 i Kodit Penal.

[71] Neni 127 i Kodit Penal.

[72] Neni 128 i Kodit Penal.

[73] Neni 129 i Kodit Penal.

urrejtje. Veprat e tilla janë: lëndimi trupor;^[74] lëndim i rëndë trupor,^[75] privim i kundërligjshëm i lirisë^[76] dhe kërcënim i sigurisë.^[77]

Ndryshimet e reja (2023) të Kodit Penal përfshijnë edhe veprën penale të përndjekjes, për të cilën parashikohet gjobë ose burgim deri në tre vjet. Është rregulluar edhe vepra penale e ngacmimit seksual, për versionin e rëndë të së cilës parashikohet dënim me burg nga gjashtë muaj deri në tre vjet.^[78] Gjithashtu, vepra penale e ngacmimit seksual dhe përdhunimit^[79] është ndryshuar dhe përkufizuar si më poshtë: personi i cili në kundërshtim me vullnetin e shprehur qartë të një personi tjetër, të vlerësuar në kontekstin e rrethanave të rastit, kryen marrëdhënie seksuale ose disa akte të tjera seksuale ekuivalent me të, të cilat konsistojnë në depërtimin vaginal, anal ose oral me ndonjë pjesë të trupit ose objekti, ose që nxit një person tjetër pa pëlqimin e tij ose të saj të kryejë marrëdhënie seksuale ose akte të tjera seksuale me një person të tretë, ose të kryejë akt seksual me veten, dënohen me burgim prej një deri në tetë vjet.

Për të analizuar zbatimin e dispozitave të lartpërmendura të Kodit Penal në rastet e femicideve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, do të ishte udhëzuese të jepej një pasqyrë e përmblodhur e llojeve më të shpeshta të dënimeve të dhëna nga gjykatat në katër vitet e fundit, duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm të veprave kriminale. Duhet theksuar nëse, në praktikë, vendimet e gjykatave tentojnë të shqiptojnë dënime më të lehta, si dënime me kusht ose gjobë, më të buta në krahasim me ashpërsinë e veprës së kryer në rastet e femicideve; nëse dhe sa është vonuar procesi gjyqësor; nëse ka padi pronësore për dëmshpërblim, nëse ato zgjidhen në një proces të vetëm gjyqësor, apo nëse viktimi apo i dëmtuari/palët duhet të hapin një padi civile etj. Ky lloj monitorimi statistikor i situatës në praktikë ka rëndësi të veçantë në mënyrë që të sigurohet një përgjigje më efektive sistematike ndaj rasteve të femicideve, me synim rritjen e besimit tek institucionet gjyqësore.

[74] Neni 130 i Kodit Penal.

[75] Neni 131 i Kodit Penal.

[76] Neni 140 i Kodit Penal.

[77] Neni 144 i Kodit Penal.

[78] Neni 190a i Kodit Penal.

[79] Neni 186 i Kodit Penal.

Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin

Hulumtimi kombëtar është kryer në fillim të vitit 2023 dhe përmban një analizë të thelluar të praktikës gjyqësore në Maqedoninë e Veriut në lidhje me femicidin.^[80] Hulumtimi është realizuar nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, me mbështetjen e Qendrës AIRE.

Të dhënat sasiore

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022, në Maqedoninë e Veriut janë zhvilluar 17 procese gjyqësore penale në lidhje me femicidin, të cilat kanë përfunduar me vendime të formës së prerë. Në nivelin e Gjykatës së Apelit, nga gjithsej 17 procese të përfunduara, 14 ishin në fushën e juridiksionit të Gjykatës së Apelit në Shkup dhe tre në atë të Gjykatës së Apelit Manastir.

Për sa i përket cilësimit ligjor, nga gjithsej 19 vepra penale, u zhvilluan 8 procese gjyqësore për vrasjen e kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje si vepër e përfunduar; u zhvilluan 8 procese gjyqësore për tentativë vrasje të kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje; dhe një proces gjyqësor për vrasje si vepër themelore. Në një proces gjyqësor për vrasje në tentativë të kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje, cilësimi ligjor gjatë procesit gjyqësor është ndryshuar në lëndim të rëndë trupor gjatë ushtrimit të dhunës në familje, ndërsa në një proces tjetër gjyqësor për vrasjen në mënyrë mizore, cilësimi ligjor është ndryshuar në vrasje në formën themelore.

Të 19 krimet janë kryer në një banesë, shtëpi apo oborr ku jetonte viktima. Në tetë raste i akuzuari ka pasur në zotërim armë zjarri, në tri raste nuk ka pasur në zotërim armë zjarri dhe në tetë rastet e tjera nuk është vërtetuar dhe kështu nuk dihet nëse autori ka pasur apo jo armë zjarri. Në gjashtë raste autori e ka keqpërdorur armën e zjarrit.

Profili i autorëve të veprave

Nga gjithsej 17 autorë të femicideve, tre autorë ishin të moshës 18-25 vjeç, dy të moshës 25-32 vjeç, katër të moshës 33-40 vjeç, tre të moshës 41-48 vjeç, dy të moshës 49-56 vjeç, dy të moshës 57 -65 vjeç dhe një mbi 65 vjeç. Shtatë autorë kanë qenë të dënuar më parë.

[80] Габер-Дамјановска Наташа and Гајдова Габриела, *Фемцидот во Република Северна Македонија – состојба, правна рамка и судска пракса (2018-2022)*, Qendra AIRE, 2023.

Qëndrimi i autorëve ndaj krimit ka qenë i tillë: 10 e kanë pranuar krimin, një ia ka hedhur fajin viktimës, një nuk ka dhënë shpjegim, tre nuk e kanë pranuar krimin dhe për dy autorë ky fakt nuk dihet pasi ata nuk kanë dhënë deklaratë mbi këtë pikë gjatë procesit penale. Të 10 autorët që kanë pranuar krimin janë shprehur të penduar. Nga shtatë të tjerët, katër nuk kanë shprehur pendim dhe për tre autorë ky fakt mbetet i panjohur.

Nga 17 autorët, dy ishin abuzues të alkoolizuar, ndërsa dy të tjerë ishin përdorues të lëndëve narkotike. Gjatë kryerjes së krimit 10 kishin pasur përgjegjësi penale, katër ishin me kapacitet të zvogëluar ndjeshëm dhe tre u vlerësuan se nuk kishin pasur përgjegjësi penale në kohën e kryerjes së krimit.

Profili i viktimave

Në kampion ishin 19 viktima femra. Njëra ishte i moshës 18-25 vjeç, dy ishin të moshës 25-32 vjeç, katër ishin të moshës 33-40 vjeç, tre të moshës 41-48 vjeç, gjashtë të moshës 57-65 vjeç dhe tre të moshës mbi 65 vjeç. Pjesa më e madhe e viktimave ishin në marrëdhënie aktuale ose ish-partnere intime me autorët (pesë ishin gratë e autorit, tre ishin bashkëjetuese me autorin, katër ishin ish gratë e autorit), ndërsa pjesa tjetër ishin persona në lidhje familjare me autorin e veprës (dy nëna, tre gjyshe), si dhe në marrëdhënie vjehërie (d.m.th. vjehrra, bashkëshortja e vëllait etj.).

Vendimet e gjykatave konstatojnë se katër viktima janë ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës para femicidit apo tentativës për femicid. Dhuna e mëparshme nuk është konstatuar në raste të tjera. Pesë prej viktimave nuk kanë kërkuar ndihmë apo mbështetje nga institucionet përkatëse, ndërsa për 14 viktimat e mbetura nuk dihet ky fakt. Para ngjarjes, një nga viktimat ka denoncuar në polici se është abuzuar nga autori, por në bazë të kallëzimit të saj nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme.

Dënimet

Në 14 procese gjyqësore, gjykata i shpalli fajtorë autorët dhe i dënoi me burgim. Në tre procese gjyqësore u caktua masa e sigurisë (mjekim i detyrueshëm në një institucion shëndetësor), duke qenë se autorët nuk kishin pasur aftësi mendore në momentin e kryerjes së krimit.

Nga gjithsej 14 dënime, tetë ishin deri në 10 vjet burgim, pesë ishin mbi 10 vjet burgim dhe një dënim me burgim të përjetshëm. Në 12 raste janë bërë ankesa.

Gjashtë vendime u lanë në fuqi, dy u lanë në fuqi pas rigjykimit, ndërsa katër u rrezuan pas rigjykimit.

Raste studimore

Studimi kombëtar për Maqedoninë e Veriut ofron një përshkrim më të hollësishëm të rasteve të femicideve dhe tentativave për femicide, duke përfshirë pesë të rasteve studimore të thelluara. Më poshtë jepen shkurtimisht dy raste studimore.

Rasti studimor nr. 1

Autori Z.K. është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, e kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje.

Gjykata e shkallës së parë ka shpallur të akuzuarin Z.K. fajtor për veprën “vrasje” të parashikuar në nenin 123 paragrafi 2(2), i lidhur me nenin 19 paragrafi 1 të Kodit Penal. Gjykata në fjalë konstatoi se më datë 4.11.2020, në periudhën kohore prej orës 17:30 deri në orën 19:30, Z.K. gjatë një akti të dhunës në familje ndaj bashkëshortes së tij S.K., në shtëpinë e tyre, me dashje ka tentuar t'i marrë jetën S.K.-së, duke e goditur atë ashpër, duke përdorur mjete të ndryshme (forcë psikike, kablllo me gjatësi 70 cm) dhe duke e kërcënuar se do ta vriste. Kjo ka zgjatur dy orë, derisa vajza e tyre A.K. erdhi në shtëpi dhe thirri policinë.

Gjykata e Apelit pranoi apelin e bërë prej tij dhe në gjykimin e ri, në bazë të udhëzimit të gjykatës më të lartë, ndryshoi cilësimin e veprës penale nga vrasje e mbetur në tentativë në lëndim të rëndë trupor. Autori u shpall fajtor për shkak të lëndimeve të rënda trupore që i kishte shkaktuar bashkëshortes. Kundër vendimit nuk u bë apel.

Në momentin e tentativës për vrasje të gruas, autori jetonte në një shtëpi me viktimën dhe ata kishin dy fëmijë të rritur. Të dy ishin të papunë dhe mbanin distancën në një godinë. Ai ishte 57 vjeç me një pamje të rregullt dhe pa ndonjë karakteristikë konkrete dhe, sipas ekspertizës, është një person me aftësi intelektuale nën nivelin mesatar, me strukturë personaliteti pasivo-agresiv dhe me tipare papjekuri emocionale, mungese stabiliteti, infantilizëm, egocentrizëm, impulsivitet, aftësi të pamjaftueshme për të përmbajtur impulset, shoqëruar me zemërim dhe acarim edhe për pengesat dhe zhgënjimet më të vogla. Ai kishte marrëdhënie të këqija të vazhdueshme me gruan e tij, duke e akuzuar për tradhti bashkëshortore dhe ishte shumë i zemëruar me të, pasi në procesin penal ndaj tij

për përdhunimin e motrës së saj, ajo nuk mbajti anën e tij, por mbështeti, sipas tij, shpifjet e motrës së saj, për të cilën ai kaloi gjashtë muaj në burg. Mbrojtja argumentoi se nuk kishte dëshmi se lëndimet e marra nga viktima ishin shkaktuar nga një goditje në kokë, si dhe se ai nuk kishte qëllim ta vriste viktimën.

Viktima ishte një grua 57-vjeçare, e përpiktë dhe me pamje modeste. Ajo ishte një person me kapacitete mesatare intelektuale, por ekspertët vunë re zhgënjimin, mungesën e vetëbesimit, pesimizmin për të ardhmen dhe nivelin e lartë të ndjeshmërisë. Ajo ishte e punësuar në tre kompani, por pas komplikimit të marrëdhënies së tyre mbeti e papunë dhe fitonte bukën e gojës duke pastruar në ndërtesa. Ajo ishte e martuar me autorin prej më shumë se 38 vitesh. Marrëdhënia e tyre ishte konfliktuale dhe pa mirëkuptim dhe ndjeshmëri reciproke. Sjellja e autorit ndaj viktimës ishte e ngjashme edhe para vuajtjes së dënimit me burg për krimin që kishte kryer ndaj motrës së saj. Sjellja e tij ndaj viktimës pas kësaj situatë jetësore u bë më armiqësore dhe agresive. Ajo as nuk kërkoi dëmshpërblim dhe as nuk u bë palë e procesit penal, ndërsa vajza e tyre nuk donte të dëshmonte. Me vendimin e parë të gjykatës ai u dënua me 10 vjet burgim për tentativë për vrasje. Gjatë rigjykimit u paraqitën të njëjtat prova. Cilësimi ligjor u ndryshua në lëndim të rëndë trupor dhe i akuzuari e pranoi veprën penale. Autori u dënua me tre vjet burgim.

Në vendimin e parë të gjykatës, rrethanat lehtësuese përfshinin qëndrimin e duhur të të akzuarit gjatë procesit penal, faktin se ai është i papunë dhe me gjendje ekonomike të dobët, se ndaj tij nuk kishte pasur proces për veprë tjetër penale dhe se aktualisht nuk është i regjistruar si autor veprë, faktet në lidhje me moshën e tij, se krimi mbeti në tentativë, se viktima as nuk i është bërë pjesë e ndjekjes penale dhe as nuk ka kërkuar dëmshpërblim. Si rrethana rënduese gjykata ka marrë parasysh këto rrethana: llojin dhe peshën e krimit, mënyrën e kryerjes së veprës, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, dënimin e tij të mëparshëm, interesin e mbrojtur dhe faktin që viktima është divorcuar nga i pandehuri pas ngjarjes dhe jeton në një adresë tjetër. Të njëjtat rrethana rënduese u paraqitën edhe në vendimin e dytë, ndërsa për rrethanat lehtësuese, përveç rrethanave të parashtruara, është marrë parasysh edhe rrëfimi dhe pendimi i autorit të veprës.

Komente

Autori dhe viktima kishin një martesë shumë të trazuar prej më shumë se 38 vitesh. Sjellja e tij ka qenë agresive ndaj viktimës edhe para vuajtjes së dënimit me burg për përdhunimin e motrës së saj dhe më pas është përkeqësuar. Ai e akuzonte viktimën për një lidhje dhe ishte vërtet i zemëruar sepse ajo mbështeti motrën e saj në vend të tij. Mirëpo, gjykata nuk është marrë me raportin mes të akuzuarit dhe viktimës që i ka paraprirë krimit. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin se viktima as nuk ka kërkuar dëmshpërblim dhe as nuk i është bërë pjesë e ndjekjes penale. Kjo është një mungesë e dukshme e ndjeshmërisë gjinore dhe dënimi i parë ishte ai minimal që parashikohet për krimin e vrasjes (dënim me burg të paktën 10 vjet deri në burgim të përjetshëm). Autori ka qenë i dënuar më parë për përdhunimin e motrës së viktimës, por gjykata vetëm e ka cilësuar këtë fakt si rrethanë rënduese, pa e vlerësuar faktin se bëhej fjalë për motrën e viktimës.

Gjykata e Apelit deklaroi se lëndimet e viktimës në kokë nuk janë konfirmuar nga ekspertët, pa marrë parasysh se ekspertiza mjeko-ligjore e viktimës është kryer një muaj pas ngjarjes. Për më tepër, gjykata nuk e mori parasysh dëshminë e viktimës. Ajo ka dëshmuar se i akuzuari e ka goditur në kokë duke thënë se ajo duhet të prehet në vend të nënës së saj, e cila kishte vdekur, gjë që tregon mundësinë që qëllimi i tij ka qenë ta vrasë viktimën.

Gjatë rigjykit, gjykata sërish nuk mori parasysh marrëdhëniet e tyre përpara ndodhjes së krimit. Burgimi me tre vjet bazohet në pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe gjykata e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese shprehjen e pendimit të të pandehurit, e cila, megjithatë, nuk del e qartë nga provat e parashtruara në procesin gjyqësor. Në mënyrë të ngjashme, ashtu si në vendimin e parë, rrethana lehtësuese ka qenë, ndër të tjera, fakti se viktima as nuk ka kërkuar dëmshpërblim dhe as nuk është bërë pjesë e ndjekjes penale. Prokurori publik nuk ka treguar fare ndjeshmëri gjinore, sidomos duke pasur parasysh se kundër vendimit për kohëzgjatjen e sanksionit penal nuk është bërë apel.

Rasti studimor nr. 2

Autori J.R është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes, pasi për shkak të marrëdhënieve të prishura më parë familjare, i ka privuar jetën bashkëshortes së tij S.R., gjatë ushtrimit të dhunës në familje, duke e goditur me thikë për vdekje në banesën e fqinjit.

Autori ishte i martuar, baba i pesë fëmijëve të mitur. Ai kishte kryer shkollën e mesme dhe ishte i dënuar më parë për krime pronësie (vjedhje dhe vjedhje të rëndë). Para ngjarjes, ai punonte dhe siguronte jetesën për familjen, me të cilën jetonte në një apartament me qira. Ai ishte i martuar me viktimën prej 15 vitesh. Marrëdhënia me viktimën ishte e trazuar. Në aktekspertizën neuropsikiatrike thuhet se në momentin e kryerjes së krimit, autori ka qenë në dijeni të veprimeve të tij, por për shkak të marrëdhënieve të prishura martesore me bashkëshorten, gjatë debatit me të, tensioni mendor i është rritur, gjë që ka ulur disi aftësinë për menaxhuar veprimet e tij, por jo në një nivel të konsiderueshëm. Në seancën kryesore i pandehuri e ka pranuar veprën penale.

Në dosjet e lëndës nuk ka shumë informacione për viktimën. Ajo ishte e martuar me autorin prej 15 vitesh dhe kishte pesë fëmijë të mitur. Ajo ishte e papunë dhe jetonte në një banesë me qira me autorin dhe fëmijët. Marrëdhëniet e tyre më parë ishin të trazura.

Duke pasur parasysh se autori e ka pranuar fajësinë, ai është shpallur fajtor dhe është dënuar me dymbëdhjetë vjet burgim. Vendimi nuk është apeluar. Siç thuhet nga gjykata, janë marrë parasysh këto rrethana lehtësuese: rrethanat personale të të akuzuarit, fakti se ai është i ri dhe se para kryerjes së veprës penale ka punuar dhe ka siguruar jetesën e familjes dhe i ka mundur familjes të banojë në një apartament me qira, fakti se është baba i pesë fëmijëve të mitur, sjellja e të pandehurit në seancën kryesore para gjykatës, se ai e ka pranuar fajin dhe ka shprehur pendesë të sinqertë, se ka kontribuar për përfundimin efikas të procesit penal, si dhe fakti që i pandehuri në ditën kritike ka qenë në dijeni të veprimeve të tij, por për shkak të marrëdhënieve të prishura martesore me bashkëshorten, i është rritur shumë tensioni mendor gjatë debatit me të ndjerin, gjë që ka ulur disi aftësinë e tij për të menaxhuar veprimet e tij, por jo deri në nivelin që do të vinte në pikëpyetje aftësinë e tij për të arsyetuar dhe për të marrë vendime. Gjykata ka vlerësuar si rrethana rënduese këto pika: i akuzuari ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së veprës penale; shkalla e rrezikimit të interesit të mbrojtur ka qenë e lartë, duke pasur parasysh se, përmes kryerjes së veprës konkrete, ai ka

vënë në rrezik të drejtën e viktimës për jetën, e drejtë e cila gëzon mbrojtje të karakterit absolut; në rastin konkret bëhet fjalë për një krim të kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje, gjë që tregon për një shkallë më të lartë të cenimit të objektit të mbrojtur; jetesa e mëparshme e të akuzuarit, d.m.th. dënimet e mëparshme dhe mjedisi i burgut nuk e kanë ndihmuar atë të jetë më i kujdesshëm për sjelljen e tij në të ardhmen.

Komente

Para kryerjes së krimit autori dhe viktima kanë pasur një marrëdhënie të trazuar. Ata ishin të martuar prej 15 vitesh. Ai kishte dënime të mëparshme penale dhe kishte vuajtur një vendim dënimi me burg.

Kur caktoi dënimin, gjykata nuk është marrë me marrëdhënien mes autorit dhe viktimës që përpara ngjarjes dhe që ka çuar në kryerjen e krimit. Gjithashtu, gjykata nuk ka marrë parasysh pakujdesinë e autorit, pra faktin që ngjarja ka ndodhur në prani të fqinjit, në banesën e tij. Gjithashtu, gjykata mori në shqyrtim pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke e cilësuar si kontribut të tij në përfundimin efikas të procesit gjyqësor. Gjukata e vlerësoi si rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari ishte baba i pesë fëmijëve, duke mos marrë parasysh se me kryerjen e aktit të femicidit i kishte lënë të pestë fëmijët pa nënë.

Nga ana tjetër, si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi se është cenuar jeta, si një nga të drejtat më të mbrojtura ligjërisht dhe se vepra është kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje, gjë që tregon një nivel më të lartë të cenimit të objektit të mbrojtur. Megjithatë, dënimi i dhënë nga gjykata është rreth minimumit ligjor për formën konkrete të rëndë të krimit të vrasjes (për të cilën parashikohet një dënim me burg nga të paktën 10 vjet deri në burgim të përjetshëm).

SERBIA

Kuadri ligjor

Në Kodin Penal të Republikës së Serbisë,^[81] vrasjet parashikohen si vrasje të thjeshta, vrasje të rënda dhe vrasje të privileguara.

Vrasja e thjeshtë përkufizohet si: kushdo që shkakton vdekjen e personit tjetër dënohet me burgim nga pesë deri në 15 vjet.^[82]

Vrasjet e rënda^[83] dënohen me 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm, domethënë kushdo që:

- » shkakton vdekjen e tjetrit në mënyrë mizore ose tinëzare;
- » shkakton vdekjen e tjetrit me sjellje të dhunshme të pashpirt;
- » shkakton vdekjen e tjetrit dhe me paramendim rrezikon jetën e tjetrit;
- » shkakton vdekjen e tjetrit gjatë kryerjes së grabitjes ose vjedhjes së shoqëruar me akte dhune;
- » shkakton vdekjen e tjetrit për përfitim, për të kryer ose për të fshehur një vepër tjetër, për hakmarrje të pashpirt ose për motive të tjera të ulëta;
- » shkakton vdekjen e një zyrtari ose ushtaraku gjatë ushtrimit të detyrës ose në lidhje me kryerjen e detyrës;
- » shkakton vdekjen e gjyqtarit, prokurorit publik, zëvendësprokurorit publik ose policëve lidhur me kryerjen e detyrës;
- » shkakton vdekjen e personit që kryen detyrën për interes publik lidhur me kryerjen e detyrës;
- » shkakton vdekjen e një fëmije ose gruaje shtatzënë;
- » shkakton vdekjen e një anëtarit të familjes së tij të cilin e ka abuzuar më parë;
- » me paramendim shkakton vdekjen e disa personave, jo vrasje nga pakujdesia si krim pasioni, vrasjen e foshnjës ose vdekjes nga mëshira, dënohet me burgim për të paktën dhjetë vjet ose me burgim nga tridhjetë deri në dyzet vjet.

[81] Kodi Penal i RS-së, *Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 85/2005, 88/2005 – korrigjim, 107/2005 – korrigjim, 72/2009, 111/2009, 121/2012, 104/2013, 108/2014, 94/2016, dhe 35/2019.

[82] Neni 113 i KP-së.

[83] Neni 114, para. 1 i KP-së.

Vrasjet e privileguara janë:

- » vrasja nga pakujdesia si krim pasioni, i cili përkufizohet si:^[84] kushdo që shkakton vdekjen e një tjetri ndërsa përfshihet në një valë të papritur pasionesh pa fajin e tij përmes sulmit, abuzimeve ose fyerjeve të rëndë ndaj të vrarëve, dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet.
- » vrasja e foshnjave (infanticidi):^[85] nëna që shkakton vdekjen e fëmijës së saj gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, në gjendje të çrregullimit të shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- » vrasja për mëshirë:^[86] kushdo që shkakton vdekjen e një të rrituri për mëshirë për shkak të sëmundjes së rëndë të personit të tillë dhe me kërkesë serioze dhe të qartë të atij personi, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- » vrasja nga pakujdesia:^[87] kushdo që shkakton vdekjen e tjetrit nga pakujdesia, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Gjithashtu, Kodi Penal parashikon se dhuna në familje është e ndaluar.^[88] Dhuna në familje përkufizohet si vijon: kushdo që përmes përdorimit të dhunës, kanosjes për sulme ndaj jetës ose trupit të personit, sjelljes së padenjë ose të pamëshirshme rrezikon qetësinë, integritetin fizik ose gjendjen mendore të një anëtari të familjes së tij, dënohet me burgim prej tre muajsh deri tre vjet. Nëse gjatë kryerjes së dhunës në familje përdoren armë, mjete të rrezikshme ose mjete të tjera të përshtatshme për të shkaktuar lëndime të rënda trupore ose për të dëmtuar rëndë shëndetin, autori dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Nëse dhuna në familje çon në vdekjen e një anëtari të familjes, autori i veprës dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa nëse anëtari i familjes është i mitur, autori i veprës dënohet me të paktën dhjetë vjet burgim.

Si në shumicën e vendeve të rajonit, në Kodin Penal të Republikës së Serbisë **nuk ka ndonjë inkriminim konkret për veprën penale të femicidit**. Femicidi mund të cilësohet si:

[84] Neni 115 i KP-së.

[85] Neni 116 i KP-së.

[86] Neni 117 i KP-së.

[87] Neni 118 i KP-së.

[88] Neni 194 i KP-së.

- » vrasje e thjeshtë;^[89]
- » vrasja e një gruaje e kryer nga urrejtja ndaj grave mund të trajtohet si vrasje e rëndë e kryer për motive të tjera të ulëta;^[90]
- » si formë e rëndë e veçantë e veprës penale të dhunës në familje kur shkaktohet vdekja e një anëtari të familjes;^[91]
- » një formë e vrasjes së rëndë:
 - » shkaktimi i vdekjes së një gruaje shtatzënë^[92]
 - » shkaktimi i vdekjes së një anëtari të familjes, me të cilin është abuzuar më herët.^[93]

Neni 54 i Kodit Penal, i cili përcakton parimet e përgjithshme të dënimit, parashikon se gjykata gjatë caktimit të dënimit duhet të marrë parasysh edhe motivet e kryerjes së veprës.

Gjithashtu, në bazë të nenit 54a të Kodit Penal, gjykata duhet të marrë parasysh si rrethanë të veçantë rënduese për marrjen e vendimit rrethanën në të cilët vepra është kryer vepra me urrejtje, e cila, ndër të tjera, mund të jetë për shkak të gjinisë së viktimës, orientimit seksual, identitetit gjinor, me përjashtim të rasteve kur kjo rrethanë parashkruhet si element i një krimi të caktuar. Kjo do të thotë se nëse nuk zbatohet dispozita për vrasje të rëndë të kryer për motive të ulëta, për të cilën parashikohet dënim më i rëndë, gjykata, sa i takon dënimit të autorit, mund të trajtojë urrejtjen për motive mizogjene dhe seksiste si një nga motivet bazë.

Përmes zbatimit të dispozitave të mësipërme në kushtet aktuale, sigurisht që është e mundur që femicidi të ndiqet penalisht, por në bazë të legjislacionit aktual kjo formë kriminaliteti nuk mund të monitorohet dhe të shtypet saktësisht. Përveç kësaj, baza ligjore nuk bën të mundur vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të reagimit të shtetit.

Hulumtimi gjyqësor mbi femicidin

Hulumtimi i kryer në Serbi përfshin karakteristikat dhe sanksionet e lidhura me krimin e femicidit dhe tentativës për femicid bazuar në analizën e praktikës gjyqësore përmes përpunimit të çështjeve të femicidit dhe tentativës për femicide

[89] Neni 113 i KP-së.

[90] Neni 114, para. 1, pika 5 i KP-së.

[91] Neni 193 i KP-së.

[92] Neni 114, para. 1, pika 9 i KP-së.

[93] Neni 114, para. 1, pika 10 i KP-së.

në periudhën 2015-2019. Hulumtimi është kryer në dy faza, dhe rezultatet e hulumtimit jepen në tre studime.^[94]

Të dhënat sasore

Në periudhën e mbuluar nga hulumtimi (2015-2019), janë proceduar plotësisht dhe janë përfunduar 124 çështje; nga ky numër ka pasur 30 çështje tentative për femicid (vrasje në tentativë dhe vrasje të rëndë në tentativë) dhe 94 çështje femicidi (vrasje, vrasje e rëndë, vrasje nga pakujdesia si krim pasioni, dhunë në familje me pasojë vdekjen e një anëtari të familjes).

Femicidi në vendimet e gjykatës është klasifikuar si: vrasje (45%), forma të ndryshme të vrasjes së rëndë (47%), vrasje nga pakujdesia si krim pasioni (2%), lëndim i rëndë trupor me pasojë vdekjen (3%) dhe dhunë në familje me pasojë vdekjen (3 %). Numri më i madh i veprave penale të kryera ishin vrasjet e rënda, gjithsej 47 raste, të kryera në mënyrë të pavarur ose njëkohësisht me vepra të tjera penale. Numri i përgjithshëm i vrasjeve të parashikuara në nenin 113 të Kodit Penal, të kryera në mënyrë të pavarur ose në të njëjtën kohë me vepra të tjera penale, ishte 45. Gjithashtu, u raportuan dy vrasje nga pakujdesia si krim pasioni, tre lëndime të rënda trupore me pasojë vdekjen dhe tri vepra penale të dhunës në familje me pasojë vdekjen. Shumica e tentativave të vrasjeve janë kryer në mënyrë të pavarur, gjithsej 23, dy janë kryer njëkohësisht me vepra të tjera penale dhe tetë vepra janë cilësuar si vrasje e rëndë në tentativë.

Femicidet dhe tentativat për femicide janë më të zakonshme në qytete sesa në fshatra. **Si femicidet ashtu edhe tentativat për femicide kryhen më së shpeshti në banesën/shtëpinë/oborrin e viktimës dhe në banesën/shtëpinë/oborrin që viktimja përdorte bashkë me dhunuesin**, gjë që konfirmon se vendi më pak i sigurt për një grua është në të vërtetë shtëpia e saj.

Shumica e vrasjeve janë kryer duke përdorur armë të ftohta (35.1%) dhe forcë fizike (21.2%), pasuar nga përdorimi i disa mjeteve (20.2%) dhe armëve të zjarrit (14.8%). Mjetet më të shpeshta të përdorura në tentativat për femicide ishin armët e ftohta (45.4%), pasuar nga armët e zjarrit (21.2%) dhe disa mjete të përdorura për kryerjen e veprës penale (18.2%). Analiza e përshkrimit të metodave të kryerjes së tentativës për femicide dhe femicideve tregon se janë përdorur metoda të ndryshme të kryerjes së veprës, të tilla si: goditja me shufër, shkop, çekiç, sëpatë, krik të makinës hidraulike, shufër, lopatë; gjuajtja me pushkë

[94] Mund të gjendet në: <http://femplatz.org/index.php?t16>

gjuetie, pistolete, hedhje bombe; therje me thikë; goditje me grushte, shkelma, goditje në kokë dhe trup me grushte; mbytje me jastëk, mbytje; derdhja e benzinës mbi viktimën dhe vënia e flakës. Në një rast, autori ka përdorur forcë fizike për ta detyruar viktimën të pijë acid muriatik, ndërsa në një rast tjetër autori fillimisht e ka plagosur viktimën (një foshnjë vajzë) duke përdorur duart, më pas e ka futur në frigorifer për disa minuta dhe më pas e hodhi nga dritarja e pallatit ku banonin. Të gjitha këto metoda të kryerjes së veprave penale tregojnë se në shumicën e rasteve autorët kanë treguar brutalitet dhe egërsi të madhe ndaj viktimës.

Sanksionet

Sanksioni mbizotërues për autorët e femicideve ka qenë me burgimi (63,2%), ndërsa në 20,4% të rasteve është dhënë vendim për burgim dhe masë sigurie, përkatësisht trajtim i detyrueshëm psikiatrik dhe izolim në institucion mjekësor, konfiskim objektsh, konfiskim armësh, trajtim i detyrueshëm i varësisë ndaj drogës. Masa e sigurisë është vendosur vetëm për 15,04% të autorëve të cilët vuanin nga "sëmundje mendore" në momentin e kryerjes së veprës penale dhe, për rrjedhojë, nuk kishin aftësi mendore. Dënimet me burgim janë dhënë për kohëzgjatje të ndryshme, në varësi të llojit të veprës penale të kryer dhe të rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Në përgjithësi, shumica e dënimeve me burg të dhëna nga gjykatat ishin për burgim afatgjatë. Dënimet varionin nga tre deri në 40 vjet burg. **Në numrin më të madh të çështjeve gjykatat kanë dhënë dënim me 40 vjet burgim, pasuar nga 15 vjet burgim (15,4% secili), 20 vjet burgim (14,08%).** Në disa raste të femicideve, gjykatat e shkallës së dytë kanë marrë vendime për dënime më të buta në krahasim me vendimet e gjykatave të shkallës së parë; kjo për shkak të ndryshimit të cilësimit ligjor të veprës penale.

Për sa i përket dënimeve të gjykatave për tentativë për femicid, gjithsej 78.8% e dënimeve ishin me burgim, qoftë me burgim të pavarur apo me burgim së bashku me masa sigurie dhe me gjoba. Dënimi më i butë ishte tre vjet burg dhe masë sigurie konfiskim i sendeve dhe vetëm në një rast është dhënë vendim me 20 vjet burgim me dy masa sigurimi, përkatësisht konfiskim i sendeve dhe trajtim i detyrueshëm për alkoolizëm. **Numri më i madh i dënimeve ishte dënimi me pesë vjet burgim (19.2%), me katër vjet burgim (15.4%) dhe tre vjet burgim (11.5%).**

Profili i autorëve të veprave

Të dhënat për moshën e autorëve të femicideve dhe tentativave për femicide kanë mbetur në masë të madhe të panjohura për shkak se ato ishin anonimizuar,

kështu që nuk mund të nxirren përfundime të vlefshme se cila kategori moshe dominon. Megjithatë, të dhënat e disponueshme sugjerojnë se grup moshat 49-56 dhe 33-40 vjeç (11,2% secila) janë më të zakonshmet për autorët e femicideve dhe dominon kategoria e grup-moshës 25-56 vjeç (39,4%) për autorët e tentativës për femicid, gjë që është e kuptueshme duke pasur parasysh natyrën e veprave penale të kryera (veprat penale të dhunshme, partneritetet intime).

Shumica e autorëve të femicideve, në momentin e krimit, ishin në një marrëdhënie lidhjeje, qoftë lidhje martesore apo zakonore. Sipas të dhënave të disponueshme, numri më i madh i autorëve të femicideve ose tentativave për femicide ka mbaruar vetëm shkollën fillore ose të mesme. Në shumë vendime mungojnë të dhënat për profesionin e autorëve, sepse të dhënat ose ishin anonimizuar ose gjykata nuk e kishte deklaruar profesionin. Gjithashtu, mungojnë të dhënat për punësimin. Megjithatë, sipas informacioneve të disponueshme, më shumë autorë të femicideve dhe tentativave për femicide kanë qenë të papunë sesa të punësuar.

Rreth një e treta e autorëve kanë qenë të dënuar paraprakisht për vepra të ndryshme penale, të tilla si: vrasje, lëndim i lehtë trupor, lëndim i rëndë trupor, vjedhje, vjedhje e rëndë, prodhim, mbajtje dhe qarkullim i paligjshëm i armëve dhe lëndëve shpërthyesë, përdorim i paautorizuar i automjetit të tjetrit, dhunë në familje, falsifikim dokumentesh, etj. Tre autorë të femicideve ishin dënuar më parë për disa vepra penale të dhunës në familje, të dënuar me burgim dhe pas vuajtjes së dënimit kanë vazhduar të ushtrojnë dhunë në familje ndaj së njëjtës viktimë.

Në 48,9% të çështjeve autorët e femicideve nuk kishin konsumuar alkool në mënyrë të tepruar përpara se të kryenin veprën. Përdorimi i tepruar i alkoolit është vërejtur në 28.5% të rasteve, ndërsa abuzimi i substancave psikoaktive apo varësia është evidentuar në 4.08% të çështjeve. Një e treta e autorëve të veprës së tentativës për femicid raportohen të kenë vuajtur nga alkoolizmi dhe 15.2% ishin të varur nga substancat psikoaktive.

Të dhënat për aftësinë mendore të autorëve të femicideve tregojnë se numri më i madh i autorëve (36.7%) është konstatuar se në kohën e kryerjes së veprës penale kanë pasur aftësi të zvogëluara, por jo në masë të konsiderueshme, që do të thotë se kanë qenë të aftë të arsyetojnë dhe të mendojnë për pasojat e vendimmarrjes dhe që ishin të vetëdijshëm se veprimi që po kryenin nuk ishte në përputhje me ligjin; 14% e autorëve kishin aftësi mendore dhe 12.2% pa aftësi. Situata është e ngjashme me autorët e tentativës për femicid, ku 36.4% e tyre kishin aftësi të zvogëluar, por jo dukshëm, rreth një e treta e tyre kishin aftësi

mendore dhe 15.2% ishin mendërisht të paaftë.

Për sa i përket qëndrimit të autorëve ndaj përgjegjësisë për ngjarjen, numri më i madh i autorëve të femicideve nuk e kanë pranuar veprën penale (22.4%), disi më pak autorë kanë shprehur keqardhje dhe pendim (14.2%) dhe po aq autorë nuk kanë dhënë shpjegim për veprën penale të kryer ose nuk ka pasur shpjegim. Përgjegjësinë për veprën e kryer e kanë pranuar 13,2% e autorëve, ndërsa 7,1% e autorëve ia kanë kaluar përgjegjësinë viktimës.

Profili i viktimave

Kampioni i hulumtimit kishte 99 viktima të femicidit dhe 35 viktima të tentativës për femicid. Meqenëse e gjithë procedura penale përqendrohet te autori, nga dosjet gjyqësore mund të mësohet shumë pak për viktimat. Në 44,4% të rasteve të femicideve nuk kishte informacion për moshën e viktimës dhe të dhënat e disponueshme tregojnë një përqindje të konsiderueshme të grave mbi moshën 65 vjeç (19,1%). Ndërmjet viktimave të femicideve kishte shtatë vajza, përfshirë edhe dy foshnja. Viktimat e tentativave për femicide janë kryesisht më të reja, deri në moshën 49 vjeç, ndërsa përqindja e viktimave të moshuara është dukshëm më e vogël. Viktimat e femicideve dhe tentativave për femicide ishin kryesisht të martuara ose në martesë pa celebrim (zakonore); megjithatë, informacioni mbi arsimimin, profesionin dhe statusin e punësimit të viktimave nuk mund të mblidhej dhe të analizohej sepse nuk ishte i pranishëm në vendimet e gjykatës.

Në rastet e femicideve ka edhe më pak informacion për viktimën sepse viktimat nuk mund të dëgjoheshin në proceset penale. Informacioni për viktimën e dhënë nga dhunuesi zakonisht nuk është objektiv, sepse ata përpiqen të përshkruajnë viktimën dhe sjelljen e saj si faktorin kryesor në kryerjen e femicideve. Edhe aty ku familjarët e viktimave janë dëgjuar si dëshmitarë, nuk rezultojnë se gjykata të ketë mësuar mjaftueshëm për viktimën dhe jetën e saj para se të vritej.

Në shumicën e rasteve viktimat nuk i ishin drejtuar organeve dhe institucioneve kompetente shtetërore për ndihmë dhe mbrojtje nga dhuna që ka qenë e pranishme para tentativës për femicid dhe femicidit. Vetëm një numër i vogël viktimash kishin raportuar raste dhune, por mënyra se si reagon institucionet e sistemit dëshmon mungesë efikasiteti nga ana e tyre dhe është tregues i mungesës së efektivitetit të sistemit për mbrojtjen e grave nga dhuna nga partneri dhe dhuna në familje.

Marrëdhëniet dhe motivet e mëparshme

Marrëdhënia më e zakonshme mes dhunuesit dhe viktimës si në rastet e femicideve ashtu edhe të tentativës për femicid ishte marrëdhënia e partneritetit intim dhe marrëdhënia familjare. Në 40,7% të femicideve ka pasur një bashkim martesor/martese zakonore/bashkim emocional të dhunuesit dhe viktimës, dhe në 8,1% të rasteve viktimat kanë qenë ish-bashkëshortë ose partnerë të zakonshëm. Sa i përket tentativave për femicide, ky numër është edhe më i lartë. Në 69.7% të rasteve ka pasur një partneritet intim (martesor, zakonor, emocional).

Tentativat për femicide dhe femicidet karakterizohen nga fakti se marrëdhënia ndërmjet autorëve dhe viktimave para kryerjes së veprës penale ka qenë kryesisht e keqe, marrëdhëniet kanë qenë të prishura, veprës penale i kanë paraprirë grindjet dhe debatet, me ose pa dhunë fizike, veçanërisht në rastet e partneriteteve intime. Duhet theksuar se në kampionin e ekzaminuar ka pasur një përqindje të lartë të femicideve të kryera nga djemtë ndaj nënave (18.3%), se marrëdhënia mes tyre para kryerjes së femicideve në shumicën e rasteve ka qenë e mirë dhe se nuk ka pasur konflikte.

Motivi më i shpeshtë për kryerjen e femicideve ishte xhelozia që buronte nga dëshira për zotërim ekskluziv të partnerit, pamundësia për të kontrolluar sjelljen e saj dhe për të menaxhuar jetën e saj. Autorët deklaruan se nuk do ta kishin kryer veprën penale kurrë nëse partnerja e tyre do t'u kishte qenë "besnike", nëse nuk do të kishte "gjetur një burrë tjetër", nëse nuk do të kishte "ndërprerë marrëdhënien", po të mos e linte, nëse do të pajtuar me ta, nëse do të pranonte çfarë ata kishin kërkuar prej saj. Sa i përket tentativave për femicide, motivet mbizotëruese ishin xhelozia, hakmarrja për prishjen e një marrëdhënieje emocionale dhe bashkimi martesor/zakonor, si dhe urrejtja dhe neveria për shkak të dashurisë së pakthyer.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Si arsyetim për vendimet e marra lidhur me dënimet për femicidet, gjykatat në përmendin rrethana të ndryshme lehtësuese në lidhje me gjendjen martesore ose familjare të autorëve të veprave (numri i fëmijëve, fakti që autori nuk kishte fëmijë, që ishte i pamartuar, por edhe që ishte i martuar, që autorit i është ndërprerë "bashkimi martesore", moshë (i ri, "në moshë të avancuar", "person në moshë të pjekur"), gjendja shëndetësore ("ka një sërë sëmundjesh të rënda fizike me ndërlikime të theksuara fizike, neurologjike dhe mendore"; simptoma psikotike nëse nuk merr terapi të përshtatshme, për këtë arsye merr trajtim mjekësor herë pas here"), pa dënime paraprake, pranim i veprës penale, qoftë edhe pranim i pjesshëm, pendim, status i papunësisë dhe kështu me radhë.

Me rastin e dënimit të autorëve të femicidit, gjykatat kanë konstatuar këto rrethana rënduese: dënimet e mëparshme, pakujdesia në kryerjen e veprës penale, sjellja e autorit pas kryerjes së veprës penale (fshehja e trupit të pajetë të viktimës dhe të mjetit të përdorur për kryerjen e veprës penale; fshehja pas kryerjes së veprës), shkalla e fajësisë ("dëshira e fortë e autorit për të ndodhur pasoja, këmbëngulja dhe paramendimi intensiv"), autori kishte kryer vepra penale edhe kur ishte i mitur, prania e fëmijëve në momentin e kryerjes së veprës penale, mungesa e pendimit real, trajtimi i viktimës në momentin e kryerjes së veprës penale, humbja e nënës së fëmijëve etj. Duhet të theksohet se në disa raste në arsyetimin e vendimeve nuk ka pasur fare rrethana lehtësuese apo rënduese, dhe ka pasur disa vendime që kanë përmendur vetëm se gjykata nuk ka gjetur rrethana rënduese.

Ashtu si në rastet e femicideve, edhe në rastet e tentativës për femicid, gjykata trajtonte kryesisht rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Gjithashtu, si rrethana lehtësuese u konstatuan: tentativa për vetëvrasje pas kryerjes së veprës penale, viktima ka vendosur të mos marrë pjesë në procesin penal dhe të përfshihet në ndjekjen penale, viktima është pajtuar me autorin dhe i ka kërkuar gjykatës që të mos jetë e rreptë me të. Duhet theksuar se në disa raste gjykata e ka parë si rrethanë lehtësuese faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë dhe nuk është kryer. Tentativa është një nga fazat e kryerjes së veprës penale dhe mund të merret si bazë për uljen e dënimit dhe të trajtohet si rrethanë lehtësuese nëse sjellja e autorit pas kryerjes së veprës penale e largon pasojën. Megjithatë, nëse vepra penale ka mbetur në tentativë dhe nuk është kryer vetëm "për shkak se kryerja e veprës penale është penguar nga veprimet e viktimës" ose për shkak të disa rrethanave të tjera (dhënia në kohë e ndihmës mjekësore), atëherë fakti që nuk ka pasur pasoja nuk mund të trajtohen si rrethanë lehtësuese.

Rastet studimore

Rasti studimor nr. 1

Autori R.D ka tentuar t'i marrë jetën bashkëshortes R.T. duke iu afruar automjetit ku ajo ishte ulur në sedijen e pasagjerit dhe ka qëlluar me pistoletë katër herë në drejtim të bashkëshortes. Pistoletën ai e mbante në mënyrë të paligjshme. Plumbat u gjuajtën njëri pas tjetrit në një interval të shkurtër kohor. Lëndimet e shkaktuara përbënin një dëm të rëndë trupor me rrezik për jetën. Vdekja u parandalua për shkak të trajtimit mjekësor në kohë dhe të duhur. Pas tentativës për femicid, autori ka tentuar të vrasë veten. Të dhënat për moshën e autorit, arsimin, profesionin dhe nëse ishte i papunë apo jo janë anonimizuar nga vendimi i gjykatës. Autori është babai i një fëmije të mitur.

Autori R.D fillimisht u mbrojt duke heshtur, ndërsa më pas deklaroi se *“po merrte terapi shumë të fortë, për këtë arsye nuk mund të rindëronte plotësisht ngjarjet nga e kaluara dhe se nuk i mbante mend ngjarjet e asaj dite”*. Mbrojtësi i autorit ndër të tjera sugjeroi edhe lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, por prokuroria nuk e pranoi. Në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve theksohej se autori ishte person me aftësi shumë të mira intelektuale dhe se aftësia e tij për të kuptuar domethënien e veprës penale, si dhe aftësia e tij për të kontrolluar veprimet e veta në momentin e kryerjes së veprës penale është zbehur, por jo dukshëm.

Në vendim mungojnë të dhënat për moshën, arsimin dhe marrëdhëniet familjare në familjen bazë të viktimës së tentativës për femicid. Kur dha dëshmi si në cilësinë e dëshmitarit, viktima deklaroi ndër të tjera se problemet në martesën e tyre kanë nisur që 10 vite më parë, se R.D e ka kërcënuar me armë, rast të cilin ajo e ka denoncuar në polici. Më pas asaj iu tha se pistoletë ishte konfiskuar. Kur më vonë e kërcënoi, autori në një rast i tha asaj se do ta vriste me po të njëjtën pistoletë dhe se ajo do ta “paguante shtrenjtë” denoncimin. Dhuna vazhdoi kur ajo kërkoi divorcin dhe ai e kërcënonte vazhdimisht se nuk kishte asgjë për të humbur dhe se do ta vriste. Viktima ka përshkruar me detaje ngjarjen kur autori ka qëlluar drejt saj, gjë që është pranuar nga gjykata, si dhe një pjesë të deklaratës së saj në lidhje me faktet që i paraprijnë veprës penale të kryer dhe marrëdhënieve të ndërsjella në martesë me autorin.

Autori është shpallur fajtor për dy vepra penale, vrasje e mbetur në tentativë dhe prodhim, mbajtje, mbajtje dhe qarkullim pa leje të armëve dhe lëndëve plasëse. Ai është dënuar me një dënim të vetëm me burgim për gjashtë vjet, me gjobë në mjete monetare dhe me masë sigurie konfiskim pistolette.

Gjatë marrjes së vendimit të dënimit për autorin, gjykata ka pasur parasysh këto rrethana lehtësuese: se ai nuk ka pasur dënime të mëparshme, se është baba i një fëmije të mitur, se në rastin konkret nuk ka pasur pasojë të veprës penale, domethënë vepra penale ka mbetur në tentativë, se me të njëjtën pistoletë ka qëlluar veten në kokë duke mbetur i plagosur dhe i është kërcënuar edhe jeta. Ndër rrethanat rënduese, gjykata ka marrë parasysh marrëdhënien e të pandehurit me viktimën, përkatësisht se i pandehuri ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë ndaj gruas së tij dhe se qëllimi i dënimit në këtë çështje nuk do të arrihej me një dënim më të butë.

Komente

Vepra është cilësuar si vrasje e thjeshtë, por në bazë të përshkrimit se si është kryer vepra dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat ekzistojnë elemente objektive dhe subjektive për cilësimin e veprës penale si veprë penale e kryer në mënyrë tinëzare (planifikimi i sekret dhe i fshehtë; veprimet e kryera me qëllim keqdashës, përdorimi i marrëdhënies së besimit, pafuqia e viktimës dhe mungesa e rezistencës së saj).

Dënimi me pesë vjet e gjashtë muaj burgim për vrasje të mbetur në tentativë vetëm për faktin se vdekja e synuar e viktimës është parandaluar si rezultat i trajtimit në kohë dhe të duhur të viktimës është shumë i butë për të arritur parandalimin e përgjithshëm dhe të veçantë. Një ndëshkim i tillë i butë është pasojë e faktit se gjykata ka vlerësuar gabimisht rrethanat lehtësuese, duke u dhënë atyre një rëndësi të madhe. Gjykata konstatoi se rrëfimi i veprës penale nga ana e të pandehurit, gjë që ia lehtësoi gjykatës kryerjen e procesit gjyqësor, sikurse përmendet në vendim, ishte rrethanë lehtësuese. Duke marrë parasysh se vepra penale është kryer në hapësirë publike, në prani të dëshmitarëve të shumtë, se janë paraqitur të gjitha provat që zakonisht paraqiten gjatë ndjekjes së veprave penale të kësaj natyre, është e paqartë se si pranimi i veprës penale nga autori e ka lehtësuar procedurën. Nga ana tjetër, edhe pse nga dëshmia e viktimës u mësua se autori nuk i kishte kushtuar vëmendje prindërve vajzës së tij, se sjellja e tij krijonte një atmosferë të keqe familjare për rritjen e vajzës dhe se kishte tentuar t'i merrte jetën nënës së saj, gjykata e cilësoi si rrethanë lehtësuese faktin se autori është baba i një fëmije të mitur. Gjithashtu, gjatë caktimit të dënimit, gjykata vlerësoi si rrethanë lehtësuese faktin se vepra ka mbetur tentativë dhe se pasojat e veprës penale nuk kanë ndodhur, ndonëse autori nuk është përmbajtur vullnetarisht nga kryerja e veprës, apo në fakt nuk ka ndër marrë ndonjë veprim për të parandaluar pasojat që do të ndodhnin.

Në këtë çështje, gjykata nuk trajtoi në detaje motivin gjinor të veprës penale, i cili mbeti i pashpjeguar. Gjykata nuk kërkoi të mësonte arsyet e kërcënimit të vazhdueshëm të autorit ndaj viktimës dhe të identifikonte metodat e përdorura nga autori për të kontrolluar viktimën dhe për të menaxhuar jetën e saj përpara se të tentonte përfundimisht ta vriste atë. Gjykata e përqendroi të gjithë vëmendjen te ngjarja, duke mos marrë parasysh sjelljen e dhunshme të autorit ndaj viktimës dhe natyrën themelore

të dhunës që ai ushtroi gjatë martesës, duke ushtruar pushtet dhe kontroll mbi viktimën. Sipas dëshmisë së viktimës, ajo ishte ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës që nga viti 2010, veçanërisht kërcënimeve me vdekje, si formë e dhunës psikologjike. Kërcënimi i parë me vdekje çoi në një referim për këshillim martesë. Nuk u mor asnjë masë për mungesën e autorit të veprës në seancën e këshillimit për martesën, gjë që padyshim e ka inkurajuar autorin, kështu që ai sërish ka vijuar me kërcënimet me vdekje ndaj viktimës për denoncimin e kërcënimeve të tij. Përveç kësaj, raportet e mëvonshme të kërcënimeve me vdekje nuk u ndoqën penalisht. Autorit nuk i është konfiskuar pistoleta, pasi sipas deklaratës së viktimës "ka pasur lidhje në polici", lidhje të cilën e ka përmendur edhe vetë autori. Mosmarrja e masave nga organet kompetente për mbrojtjen e viktimës nga dhuna e partnerit intim është tregues i nivelit të mungesës së efikasitetit të institucioneve të sistemit përgjegjës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Në këtë rast të veçantë, mosmarrja e masave për t'u mbrojtur nga dhuna ka kontribuar që viktima të humbasë çdo shpresë për të marrë mbrojtje institucionale, kështu që ajo ka qëndruar dhe ka jetuar me dhunuesin, duke u frikësuar për jetën e saj dhe të fëmijës së saj, duke besuar gabimisht se kjo e zvogëlonte rrezikun për t'u vurrë, rrezik me të cilin ajo kërcënohej vazhdimisht.

Rasti studimor nr. 2

Pas një shერი me gojë, autori J.M., i dehur rëndë nga alkooli, i ka marrë jetën viktimës S.V. me të cilin kishte jetuar në një martesë pa celebrim. Autori e ka kryer vrasjen në dhomën e shtëpisë ku jetonin, duke e goditur viktimën me grushte dhe shkelma. Viktima ishte goditur të paktën 16 herë në kokë dhe trup dhe ndërroi jetë në vend. Vepra u cilësua si vrasje. Në vendimin e shkallës së parë, J.M.-ja u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes. Me vendim të Gjykatës së Apelit, ky vendim u rrëzua dhe çështja u kthye për rigjykim. Në vendimin e dytë të shkallës së parë, autori u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, vendim i cili u la në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Në kohën e kryerjes së veprës penale autori J.M. ishte 54 vjeç, kishte mbaruar shkollën e mesme të inxhinierisë së ndërtimit; ishte i papunë, kishte punuar me kontrata afatshkurtra për ca kohë, e siguronte bukën e gojës duke rritur dhe shitur derra në fermë; ishte i divorcuar, kishte dy fëmijë të rritur me të cilët nuk kishte kontakte; pinte alkool çdo ditë gjatë 20 viteve të fundit, por nuk ishte trajtuar për

alkoolizëm. Ai nuk kishte asnjë dënim të mëparshëm. Në momentin e ngjarjes, niveli i alkoolit në gjak ishte 2.73 mg/ml, që klinikisht përkon me një nivel të rëndë dehjeje nga alkooli. Ai kishte qenë në një marrëdhënie intime me viktimën V.S. për dy deri në dy vjet e gjysmë.

Autori deklaroi se ishin në festën e pagëzimit të nipit të një shoku të përbashkët. Viktima ishte në humor të mirë dhe e dashur për të dhe i ishte drejtua me fjalët "*ku je, dashuria ime*", por ai kishte vënë re se ajo kishte filluar të pinte që para fillimit të festës. Ai e kishte qetësuar duke i thënë që të "*mbante frenat*", dhe ajo i ishte përgjigjur "*ma bëj*". Ajo kërcëu me një burrë të cilin ai nuk e njohte, e kapi nga pjesa e pasme dhe e përparme e trupit, e tërhoqi, u përpoq t'i ulej në prehër. Ai kishte përshtypjen se të gjithë po e shikonin dhe prisnin që ai të bënte diçka, disa madje dhe po qeshnin, gjë që ishte "*shumë e vështirë*" për të. Shoqja e tyre dhe vajza e saj u përpoqën ta qetësonin viktimën dhe edhe ai vetë bëri të njëjtën gjë duke paralajmëruar që të mos pinte më alkool dhe të mos sillej në atë mënyrë. Megjithatë, ajo nuk e dëgjoi, kështu që ai u tërhoq në cep të dhomës, u ul vetëm "*në cep*", sepse ndihej jashtëzakonisht i mërzitur. Për të ishte shumë e vështirë kur pa se viktima "*puthi një prift*" në dhomë, gjatë festës. Sipas deklaratës së tij, ata janë larguar nga festa me taksì dhe nuk kanë folur fare gjatë udhëtimit. Kur kanë arritur në shtëpi, kishin vazhduar të pinin raki dhe filluan të flasin për sjelljen e saj në festë. Kur i tha se nuk donte të jetonte me të, viktima e shau dhe tentoi ta godiste.

Autori deklaroi se nuk e dinte se mund ta vriste viktimën kur e goditi, se nuk e dinte se çfarë donte, por i vinte keq që kjo gjë kishte ndodhur. Megjithatë, gjykata nuk e pranoi këtë. Sipas vlerësimit të gjykatës, autori ka pasur aftësi mendore në kohën e kryerjes së veprës penale dhe aftësia e tij për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij dhe për të kontrolluar veprimet e tij është zvogëluar ndjeshëm. Ai e ka kryer veprën penale me dashje të mundshme, pasi fakti që ka qenë në gjendje eksitimi afektiv, i cili ka pasur formën e acarimit të forte, nuk e përjashton veprimin me dashjen.

Në vendim mungojnë të dhënat bazë për viktimën V.S., vitin e saj të lindjes, arsimin, profesionin, nëse ishte e punësuar apo jo, informacionin për familjen e saj bërthamë, jetën e saj të mëparshme, marrëdhënien me autorin, etj. Disa të dhëna janë dhënë nga autori, përkatësisht se ajo kishte dy djem dhe dy vajza.

Në vendim deklarohet si fakt i padiskutueshëm se viktima "*në festë, me veprimet dhe sjelljet e saj (u shoqërua me burra të tjerë, u ul në prehrin e tyre, i përqafoi, i kapi organet gjenitale, i tërhoqi për dore për të kërcyer me të), i shkaktoi të pandehurit ndjenjën subjektive të poshtërimit dhe gjendje afektive zemërimi dhe*

tërbimi, gjendje në të cilën i pandehuri ka qenë edhe pasi janë larguar nga festa, pra edhe kur janë kthyer në shtëpi, ku i pandehuri i ka marrë jetën viktimës”.

Pika e kontestuar në këtë rast është ajo e cilësimit juridik të veprës penale të kryer nga autori, e cila fillimisht është cilësuar si vrasje, ndërsa në rigjykim si vrasje nga pakujdesia si vrasje pasioni. Gjatë procesit gjyqësor, prokurori më i lartë publik ka pohuar se autori ka kryer veprën penale të vrasjes dhe se nga provat e paraqitura nuk është vërtetuar se autori ishte në gjendje shumë të irrituar, i cila i ishte shkaktuar pa fajin e tij dhe për shkak të sjelljes së viktimës, d.m.th. duke e sulmuar, abuzuar dhe fyer rëndë atë. Megjithatë, në rigjykim gjykata ka konstatuar se autori i ka marrë jetën V.S. dhe e ka cilësuar veprën si vrasje nga pakujdesia për shkak të pasionit. Ndër të tjera, në arsyetimin e këtij vendimi, thuhej se ishte e padiskutueshme *“që i pandehuri J.M., në momentin e marrjes së jetës së viktimës, ka qenë në një gjendje eksitimi afektiv të një intensiteti dhe cilësie të tillë që ka marrë formën i acarimit të fortë, gjendje në të cilën ai reagoi në një valë pasioni, pa u menduar më tej, në mënyrë të papritur, të pakontrolluar dhe shpërthyesë”*. Gjykata konstatoi gjithashtu se në çështjen në fjalë, duke qenë se autori dhe viktima ishin në një marrëdhënie emocionale, *“fyerjet nga viktima ishin të një intensiteti dhe domethënie të tillë, saqë edhe në bazë të kriterëve objektive ishin fyerje të rënda”*. Gjithashtu, në vendim thuhet: *“... domethënë, është logjika e jetës që dikush, kur bashkëshortja e të cilit, partnerja sipas ligjit zakonor, sillet ashtu si u soll viktima në atë rast, do të ndihej vetë i poshtëruar dhe i turpëruar, dhe pikërisht për shkak të ndjenjës së tij subjektive të poshtërimit dhe shqetësimit do të krijonte përshtypjen dhe ndjenjën, edhe pse në fakt mund të mos jetë kështu, se të gjithë shihnin vetëm atë dhe talleshin me të”*. Gjykata e Apelit e la në fuqi këtë vendim.

Autori u dënua me 12 vite burg për veprën penale të vrasjes me vendim të shkallës së parë. Vendimi i dytë i shkallës së parë e ndryshoi cilësimin ligjor të veprës penale dhe e dënoi autorin e veprës me shtatë vjet burg për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia si krim pasioni. Në arsyetimin e vendimit të shkallës së parë ku gjykata e dënoi autorin me 12 vjet burg, ajo konstatoi se nuk ka rrethana rënduese, ndërsa për rrethanat lehtësuese gjykata mori parasysh faktin se autori nuk ka pasur dënime të mëparshme, se ka thënë se ka ndjerë keqardhje, se ka pranuar veprën penale në aspektin e kohës, vendit dhe mënyrës së kryerjes së saj, por edhe se viktima në një farë mënyre *“ka kontribuar në veprimet e të pandehurit”*, kështu që përveç dehjes me alkool, *“sjellja e viktimës ka qenë shkak i drejtpërdrejtë afektiv për kryerjen e veprës penale”*. Në dënimin e tij me shtatë vjet burg, gjykatat e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë nuk kanë konstatuar rrethana rënduese, ndërkohë që kanë marrë parasysh rrethanat lehtësuese, të tilla si autori ka pranuar veprën penale, se ka shprehur pendim dhe faktin se ndaj tij nuk ka pasur dënime të mëparshme.

Komente

Kjo çështje përfaqëson një shembull tipik të femicidit nga partneri intim, vrasjen e një gruaje në martesë pa celebrim, e cila bazohet në rolin stereotipik gjinor të gruas, nga e cila pritet sjellje *“e hijshme dhe modeste”* në komunitetin patriarkal. Pikëpamjet e parashtruara shprehimisht nga gjykata në vendimin e saj përmes konstatimit se *“sjellja e keqe e viktimës ishte gjithashtu objektivisht shumë fyese”*, janë shprehje e qëndrimeve seksiste të gjykatës ndaj grave dhe manifestojnë qartë stereotipe gjinore për rolet shoqërore dhe sjelljen e pritshme të grave dhe burrave. Gjykata konstatoi shprehimisht në qëndrimin e saj se: *“është logjika e jetës që dikush, kur bashkëshortja e të cilit, ose partnerja në martesë pa celebrim, sillet ashtu si u soll viktima në atë rast, do të ndihej vetë i poshtëruar dhe i turpëruar, dhe pikërisht për shkak të ndjenjës së tij subjektive të poshtërimit dhe shqetësimit do të krijonte përshtypjen dhe ndjenjën, edhe pse në fakt mund të mos jetë kështu, se të gjithë shihnin vetëm atë dhe talleshin me të”*. Një *“logjikë e tillë e jetës”* si bazë për cilësimin juridik të gjykatës ilustron thellësinë e plotë të seksizmit institucional dhe është tregues se hierarkia ekzistuese gjinore, e dëmshme për gratë, është e rënjosur thellë në institucionet e sistemit.

Do të ishte e vështirë të imagjinohej situata e kundërt. E njëjta sjellje *“e keqe”* e një burri nuk do të konsiderohej *“fyerje e rëndë”* për një grua, por do të tolerohej dhe ndoshta do të justifikohej për shkak se ai ishte i dehur. Dehja e gruas, e cila padyshim që pati ndikim mbi sjelljen e saj gjatë festës, nuk ka asnjë justifikim. Në një shoqëri patriarkale me ndarje gjinore, kjo sjellje është, në vetvete, e papranueshme për shoqërinë. Nuk ka dyshim se në çdo mjedis tradicional, sjellja e një gruaje që devijon nga normat patriarkale të shoqërisë dënohet nga publiku i gjerë, ku riprodhimi i modeleve stereotipike gjinore të sjelljes së grave dhe burrave është i zakonshëm. Përfundimi i gjykatës se sjellja e viktimës përfaqëson objektivisht një *“fyerje të rëndë”* ndaj autorit është simptomatik, për shkak se në këtë mënyrë gjykata në thelb mbështet dhe promovon qëndrimet stereotipike gjinore.

Nga ana tjetër, gjykata nuk ka trajtuar fare sjelljen e autorit ndaj viktimës para vrasjes dhe nga i gjithë arsyetimi i vendimit del se vepra është kryer nga një person i jo i dhunshëm që *“shpërtheu”* për shkak të sjelljes së partneres së tij, e cila shkaktoi tek ai një ndjenjë subjektive poshtërimi, zemërimi dhe inati. Duhet të mbahet parasysh se *“shpërthimi i meshkujve”* dhe *“provokimi*

i femrave” që justifikojnë femicidin përbëjnë një tjetër shprehje të nocioneve stereotipike. Hulumtimet tregojnë se dhuna, përfshirë tentativën për vrasje, nuk është spontane dhe se pretendimet e bëra nga abuzuesit për humbjen e kontrollit, provokimin, vetëmbrojtjen emocionale dhe akuzat e tyre se partneri ishte (ose donte të ishte) seksualisht jo besnik, janë justifikime për aktet e dhunës, duke përfshirë tentativën për femicid dhe femicidin.

Analiza e çështjes tregon se stereotipet dhe paragjykimet gjinore të gjykatës kishin shumë rëndësi për interpretimin e sjelljes së viktimës dhe ndjenjave që shkaktonte sjellja e saj te dhunuesi. Qëndrime të tilla diskriminuese gjinore ndikuan që gjykata ta cilësonte aktin si vrasje nga pakujdesia si krim pasioni, ndonëse nuk kishte vazhdimësi midis *“fyerjeve të rënda”* të viktimës ndaj autorit në festë dhe vrasjes, e cila, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar, është e nevojshme të jetë e pranishme në rastet e vrasjes nga pakujdesia si krim pasioni si një formë më pak e rëndë e vrasjes, për të cilën parashikohet një dënim më i butë.^[95] Duke pasur parasysh se dënimi i vrasjes mbron jetën si vlerën më të lartë shoqërore, një dënim me shtatë vjet burg për vrasje nga pakujdesia nuk arrin as parandalimin e përgjithshëm dhe as atë të veçantë. Vetë cilësimi i krimit tregon se në rastet e vrasjes së partnereve femra për shkak të sjelljes së tyre “të lirshme” në publik, vrasësit mund të mbështeten në mirëkuptimin jo vetëm të publikut të gjerë, por edhe të gjyqtarëve profesionistë.

Vështrim i përgjithshëm mbi dënimet për vrasje dhe vrasje të rëndë në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në pjesët e raportit që kanë të bëjnë me legjislacionin penal kombëtar, janë paraqitur vepra të ndryshme penale (lloje të ndryshme të vrasjeve dhe disa vepra të tjera penale që mund të çojnë me vdekje). Këtu jepet një pasqyrë e shkurtër e dallimeve lidhur me dënimet e përcaktuara për formën themelore të krimit të vrasjes dhe vrasjes së rëndë brenda secilit juridiksioni. Vrasja e rëndë dënohet me dënime shumë më të ashpra dhe mendojmë se çdo femicid duhet të trajtohet si

[95] Sipas qëndrimit të pranuar përgjithësisht të praktikës gjyqësore, në lidhje me vrasjen nga pakujdesia si krim pasioni, vepra duhet të kryhet menjëherë pas fyerjeve të rënda. Për më tepër, ajo që gjithashtu kërkohet është “reagimi i drejtpërdrejtë dhe shpërthyes” i autorit (Gjykata e Lartë e Serbisë, ref. K.Ž. 1377/71), d.m.th. “një vazhdimësi e caktuar kohore ndërmjet fyerjes së rëndë dhe aktit të vrasjes” (Gjykata e Lartë e Serbisë, ref. K.Ž. 2727/65).

vrasje e rëndë, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e saj shoqërore dhe faktin se është, siç është paraqitur më parë, një formë specifike e vrasjes.

- a) Kjo mund të mbështetet nga neni 46 i Konventës së Stambollit, i cili trajton rrethanat rënduese. Sipas kësaj dispozite: "Palët do të marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të siguruar që rrethanat e mëposhtme, për aq sa nuk janë tashmë pjesë e elementeve përbërëse të veprës penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren parasysh si rrethana rënduese për caktimin e dënimit në lidhje me veprat e përcaktuara në përputhje me Konventën e [Stambollit]: vepra është kryer kundër një bashkëshorti ose partneri të mëparshëm ose aktual, siç njihet nga ligji i brendshëm, nga një anëtar i familjes, një person që bashkëjeton me viktimën, ose një person që ka abuzuar me autoritetin e saj;
- b) vepra penale ose veprat e lidhura me to, janë kryer në mënyrë të përsëritur;
- c) vepra është kryer kundër një personi të cenuar nga rrethana të veçanta;
- d) vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije;
- e) vepra është kryer nga dy ose më shumë persona në bashkëpunim;
- f) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele ekstreme të dhunës;
- g) vepra është kryer me përdorimin ose kërcënimin e armës;
- h) vepra ka rezultuar në dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik për viktimën;
- i) autori ka qenë më parë i dënuar për vepra të natyrës së ngjashme.

Shqipëria	vrasje	10-20 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 20 vite burgim
Federata e BiH-së	vrasje	5-20 vjet
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vite ose me burgim afatgjatë (21-45 vjet)
BiH – Republika Srpska	vrasje	5-20 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vite ose me burgim të përjetshëm
BiH – Distrikti Brčko	vrasje	Minimumi 5 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vjet ose me burgim afatgjatë (21-45 vjet)
Mali i Zi	vrasje	5-15 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vjet ose me burgim afatgjatë (30-40 vite)
Kosova	vrasje	Minimumi 5 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vite ose me burgim të përjetshëm
Maqenia e Veriut	vrasje	Minimumi 5 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vite ose me burgim të përjetshëm
Serbia	vrasje	5-15 vite
	vrasje e rëndë	Minimumi 10 vite ose me burgim të përjetshëm

» REKOMANDIME

Ky raport rajonal tregon disa dallime midis vendeve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me përgjigjen gjyqësore ndaj femicideve, por gjithashtu tregon edhe shumë ngjashmëri. Në raportet kombëtare mund të gjenden të gjitha informacionet përkatëse dhe specifike për vendet përkatëse, ndërsa në këtë pjesë do të prezantojmë shkurtimisht rezultatet kryesore që dalin nga raportet kombëtare. Për rrjedhojë, rekomandimet janë krijuar në mënyrë që të jenë të përshtatshme për secilin vend veçmas, por edhe për të gjithë rajonin të marrë së bashku.

Duke marrë parasysh shkaqet e femicideve dhe faktin se ky krim është i lidhur me gjininë, nuk është e mundur të parandalohet me sukses femicidi pa tejkalar kulturën e dhunës ndaj grave dhe pa vendosur tolerancë zero ndaj dhunës ndaj grave, pavarësisht formave dhe kontekstit në të cilin ndodh dhuna. Është e qartë se çdo vend ka nevojë për ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me qëllim të zhdukjes së paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave, pra në rolet stereotipike të grave dhe burrave.

Prandaj, për të mundësuar eliminimin e shkaqeve sistematike dhe strukturore të pabarazisë gjinore dhe për të krijuar kushte për integrimin e perspektivës gjinore në një mënyrë koherente, gjithëpërfshirëse dhe sistematike, duhet të zbatohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe gjyqësori duhet të ketë vendin e vet brenda sistemit. Parandalimi efektiv i femicidit nuk është i mundur pa burime të mjaftueshme për të zbatuar ligjet, politikat dhe procedurat për parandalimin dhe ndjekjen penale të femicideve dhe akteve të tjera të dhunës me bazë gjinore. Sa i përket burimeve njerëzore, studimi tregon se të gjithë sektorët e ngarkuar me parandalimin dhe mbrojtjen kundër dhunës kanë nevojë për trajnime shtesë, duke përfshirë edhe anëtarët e gjyqësorit, në mënyrë që të kapërcehen sfidat dhe hendeqet ekzistuese dhe të ofrohet përgjigje e përshtatshme ndaj femicideve dhe formave dhe manifestimeve të tjera të dhunës ndaj grave.

Një nga arsyet për trajtimin e papërshtatshëm të rasteve të femicideve në rajon konsiderohet të jetë zbatimi i dobët dhe joefektiv i ligjeve. Pavarësisht faktit se femicidi nuk është parashikuar shprehimisht si krim i pavarur, përveç ndryshimeve ligjore të kohëve të fundit në Maqedoninë e Veriut, ekziston mundësia ligjore që gjykata të trajtojë vrasjet e grave me bazë gjinore. Gjyqësori duhet të tregojë më shumë thellësi në analizën dhe kuptimin e këtij lloji të krimit, gjë që do të çonte në

procese gjyqësore më të drejta dhe, në fund, në dënime më të përshtatshme për autorët. Ndëshkimi i butë dhe/ose jo i përshtatshëm i të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ndaj femicidit si forma më e rëndë e saj, ndikon më tej në rritjen e mosbesimit në institucione dhe mos raportimin nga viktimat, gjë që nga ana tjetër nxit përsëritjen e dhunës dhe çon në kulminimin e saj në femicid.

Parashikimi i femicidit si vepër penale

Parashikimi i femicidit si vepër penale e veçantë në ligjet penale kombëtare është mjaft i justifikuar dhe i domosdoshëm për të klasifikuar të gjitha rastet e femicideve dhe për të zvogëluar kështu pasigurinë juridike dhe gabimet e mundshme lidhur me klasifikimin e veprës penale dhe dënimin e autorëve. Ky veprim është i rëndësishëm edhe në aspektin statistikor, pasi mundëson monitorimin e numrit të personave të raportuar, të akuzuar dhe të dënuar për femicid. Si një krim i veçantë, specifik kundër jetës dhe gjymtyrëve, femicidi do të përfshinte çdo vrasje të një gruaje me motive gjinore.

Nëse femicidet do të parashikoheshin si vepër penale e veçantë dhe e pavarur, objekti i mbrojtjes do të ishte jeta e një gruaje dhe objekti i aktit ose objekti i sulmit do të ishte vetë gruaja. Kryerja e veprës do të ishte e njëjtë si në veprën penale të vrasjes, që do të thotë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë vdekjen e një personi tjetër. Duke qenë se në praktikë vdekja mund të shkaktohet jo vetëm nga abuzimi fizik, do të ishte e nevojshme të parashikohej edhe akti i kryerjes së veprës që do të konsistonte në abuzim psikologjik (krijimi i agjitacionit, frikës, ndjenjës së vdekjes) me pasojë vdekjen. Nga elementët subjektivë, përveç qëllimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe neglizhencës si forma fajësie, duhet të ketë një motiv të bazuar në gjini. Edhe pse motivi nuk është element i detyrueshëm i natyrës së veprës penale në përgjithësi dhe, rrjedhimisht, edhe i veprës penale të vrasjes, në rastin e femicidit do të ishte me rëndësi të përcaktohet motivi i kryerjes së vrasjes (të tilla si mizogjinia, urrejtja ndaj grave, diskriminimi dhe mosrespektimi i jetës dhe integritetit trupor të gruas).

Kuadri statistikor i zhvilluar rishtazi për matjen e vrasjeve të grave lidhur me gjininë, i publikuar nga UNODC-ja dhe UN Women në vitin 2022, duhet të konsultohet si bazë për parashikimin si vepra penale të akteve të tilla në legjislacionin penal kombëtar.

Krijimi i një sistemi kombëtar për mbledhjen e të dhënave dhe përmirësimi i bazave të të dhënave gjyqësore

Sa i përket gjyqësorit, studimet kombëtare tregojnë se i gjithë procedimi penal është i orientuar te autori në rastet e femicideve dhe tentativave për femicide, me shumë pak të dhëna për viktimat. Gjithashtu, ka pasur shumë pengesa në mbledhjen e vendimeve të formës së prerë nga gjykatat, pasi femicidi nuk parashikohet si vepër penale e pavarur, ndërsa nga ana tjetër, bazat e të dhënave gjyqësore nuk përmbajnë të dhëna për gjininë e viktimave, domethënë bazat përkatëse të të dhënave nuk mund të kërkohet duke përdorur këtë kriter.

Edhe pse çdo vend ka një sistem të vetin të mbledhjes së të dhënave për dhunën ndaj grave (zakonisht jo i centralizuar), duhet theksuar se në mungesë të një veprë penale të veçantë të femicidit, nuk është e mundur të mbledhen siç duhet të dhënat lidhur me të.

Mbledhja sistematike e të dhënave për shtrirjen, strukturën dhe karakteristikat e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përfshirë edhe femicidin, duhet të krijohet përmes sistemit kombëtar të të dhënave në çdo vend. Kjo do të mundësonte monitorimin e tendencave të rritjes apo rënies në periudha të caktuara kohe dhe në fusha të caktuara është një parakusht kyç për parandalimin e suksesshëm të femicideve. Këto të dhëna sigurojnë që krijimi dhe vlerësimi i efekteve të politikave publike për parandalimin dhe kontrollin e femicideve të bazohen në të dhëna, si dhe që autoritetet përkatëse të marrin vendime të mirëinformuara. Përveç kësaj, të dhënat gjyqësore për femicidet (të paktën të dhëna të ndara sipas gjinisë për autorët dhe viktimat) do të mundësonin analizimin e përgjigjes gjyqësore ndaj vrasjeve të grave lidhur me gjininë dhe praktikave të dënimit.

Hartimi i udhëzimeve për trajtimin e çështjeve të femicideve

Hulumtimet kombëtare tregojnë mospërputhje të caktuara sa i takon proceseve gjyqësore të lidhura me femicidet, veçanërisht në aspektin e cilësimit të veprës penale dhe përcaktimit nëse bëhet fjalë për krim me bazë gjinore. Gjithashtu, rrethanat lehtësuese dhe rënduese shumë shpesh nuk shtjellohen mirë. Ka pasur edhe raste të marrëveshjeve të fajësisë midis autorit të veprës dhe prokurorisë, duke lënë familjen e viktimës "pa zë" në lidhje me marrëveshjen në fjalë dhe pa zgjidhje të duhur ligjore.

Për të siguruar procese gjyqësore efikase, të drejta dhe të përshtatshme, veçanërisht lidhur me cilësimin juridik të femicideve, dhe kuptim më të thellë të këtij lloji krimi specifik, duhet të zhvillohen udhëzime për gjyqësorin, veçanërisht për çështjet e femicideve.

Udhëzimet duhet të shpjegojnë femicidin si akt të vrasjes së grave në lidhje me gjininë dhe të ofrojnë udhëzues të përshtatur për cilësimin juridik të veprës (në mungesë të një vepre penale të veçantë) për të zvogëluar pasigurinë juridike dhe gabime të mundshme lidhur me cilësimin e kësaj vepre penale. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese duhet të analizohen dhe shpjegohen me kujdes nga perspektiva gjinore, duke përdorur shembuj ekzistues nga dosjet e çështjeve gjyqësore për të cilat është marrë një vendim i formës së prerë nga gjykatat. Udhëzimet duhet të theksojnë zbatimin e standardeve të kujdesit të duhur, si dhe të kontribuojnë për të pasur një qasje të përqendruar te viktima. Hetimi i çështjeve të femicideve, duke përfshirë përcaktimin e fakteve gjatë procesit penal, duhet të kryhet me përkushtim dhe të shkojë përtej vërtetimit të thjeshtë të fakteve të çështjes, duke marrë parasysh praninë e mundshme të qëndrimeve mizogjene të autorit të veprës, epërsinë fizike dhe dominimin, pabarazinë e forcës dhe fuqisë fizike, si dhe historikun e mëparshëm të dhunës dhe fakte të tjera përkatëse. Gjithashtu, udhëzimet duhet të përfshijnë shpjegim të detajuar të standardeve të Konventës së Stambollit në lidhje me rrethanat rënduese, siç parashikohet në nenin 46 të Konventës.

Përveç kësaj, udhëzimet duhet të përmbajnë një pjesë për të peshuar në mënyrë të drejtë dënimin në çështjet e femicideve dhe tentativave për femicide, dhe duhet të shtjellojnë nevojën për dënime më të ashpra për këto çështje.

Trajnimi vazhdues për gjyqësorin

Është e nevojshme të forcohet kapaciteti i gjyqësorit përmes zbatimit të programeve të duhura dhe përkatëse të trajnimit dhe ndërgjegjësimit gjinor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për çështjet e femicideve, duke pasur parasysh se studimi tregon se ekzistojnë stereotipe dhe paragjykime gjinore në gjyqësor.

Për rrjedhojë, për të kapërcyer stereotipet gjinore dhe seksizmin institucional, për të kuptuar fenomenin e femicidit dhe për të çrrënjosur paragjykimet seksiste dhe vlerat dhe praktikat patriarkale të bazuara në rolet stereotipike gjinore të grave dhe burrave, duhet të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për profesionistët e së drejtës.

Do të ishte e dobishme që ky proces të organizohej në disa faza. Së pari, gjyqtarët dhe prokurorët përgjegjës për dhunën ndaj grave, duke përfshirë rastet e femicideve, duhet të marrin trajnim bazë për ndërgjegjësimin gjinor. Ky trajnim duhet të jetë i përshtatur për gjyqësorin dhe duhet të përfshijë tema që kanë të bëjnë me pozitën e grave dhe burrave në shoqëri, shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit, stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe, më konkretisht, ndikimin e stereotipeve dhe paragjytimeve gjinore në dhënien e drejtësisë. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me akademitë gjyqësore ose shkollat e magistraturës të secilit juridiksioni. Gjithashtu, ky trajnim bazë mund të organizohet online ose me praninë fizike të pjesëmarrësve dhe në fund të tij duhet të jepen certifikata ose stimuj të tjerë të përshtatshëm për gjyqtarët dhe prokurorët. Qendra AIRE ka ofruar trajnime online për çështjet gjinore për gjyqësorin gjatë vitit 2021 dhe mund të jetë një pikënisje e mirë për gjyqësorin, me synimin për të rritur ndërgjegjësimin e profesionistëve të drejtësisë.

Faza tjetër duhet të jetë trajnimi më i avancuar konkretisht për fenomenin e dhunës ndaj grave, duke u përqendruar te femicidi. Ky trajnim duhet t'u mundësojë profesionistëve të gjyqësorit të kuptojnë ndërlidhjen midis koncepteve të ndryshme që lidhen me (pa)barazinë gjinore nga trajnimi bazë dhe fenomenit të dhunës ndaj grave që mund të çojë në femicide. Trajnimi mund të ofrohet edhe online, por do të ishte më mirë të organizohej me praninë fizike të pjesëmarrësve, me trajnerë të njohur dhe me emër të fushës që kanë një reputacion të mirë në të gjithë rajonin. Gjithashtu, trajnimi duhet të përfshijë prezantimin e udhëzimeve për gjyqësorin në rastet e femicideve, të cilat do të zhvillohen nga Qendra AIRE.

Krijimi i një mekanizmi monitorimi për femicidin në çdo shtet dhe krijimi i një mekanizmi rajonal monitorimi për femicidin

Duhet të krijohet një mekanizëm (Rojtari i femicideve/Observatori për parandalimin e femicideve) në përputhje me rekomandimet e Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për Dhunën ndaj Grave, drejtuar të gjitha shteteve dhe që kërkon mbledhjen dhe analizën e të dhënave për dhunën ndaj grave dhe zbulimin e mosveprimeve që çojnë në vrasje të grave për shkak të gjinisë.

Pas krijimit të mekanizmave kombëtarë të monitorimit të femicideve dhe duke pasur parasysh ngjashmëritë midis shteteve të Ballkanit Perëndimor, duhet të krijohet një mekanizëm rajon për monitorimin e femicideve. Mekanizmi rajon për monitorimin e femicideve, që formohet si rezultat i bashkëpunimit midis mekanizmave kombëtarë për monitorimin e femicideve, do të mundësonte

krahasimin e situatës ndërmjet vendeve dhe analizimin e faktorëve të suksesit, shkëmbimin e praktikave më të mira, si dhe mësimin nga përvojat e vendeve të tjera. Kjo mund të kontribuojë për bashkëpunimin ndërsektorial ndërmjet institucioneve kompetente në fushën e parandalimit dhe luftimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe femicideve, bazuar në një qasje dhe mirëkuptim të integruar.

Vendimet e formës së prerë të gjykatave për çështjet e femicideve dhe tentativave për femicide duhet të jenë pjesë thelbësore e mbledhjes së të dhënave të monitorimit të femicideve dhe analizave të mëvonshme.

Shkëmbimet e njohurive dhe praktikave gjyqësore midis vendeve të rajonit

Sikurse u theksua më sipër, ka shumë ngjashmëri midis vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) që lidhen jo vetëm me kuadrin ligjor, por edhe me mentalitetin, normat shoqërore mbizotëruese, pozicionin e burrave dhe grave brenda shoqërive përkatëse, së bashku me standardet ndërkombëtare që duhet të arrijnë dhe të zbatojnë vendet e Ballkanit Perëndimor. Për rrjedhojë, do të ishte shumë e dobishme për profesionistët e gjyqësorit në rajon që të kenë mundësi të takohen me kolegët e tyre dhe të shkëmbejnë rregullisht njohuri dhe përvoja me ta.

Kjo nënkupton forma të ndryshme aktiviteteve. Për shembull, gjyqtarët dhe prokurorët përgjegjës për dhunën ndaj grave, duke përfshirë femicidet, duhet të takohen rregullisht, çdo herë në vende të ndryshme për të ndarë praktikën e tyre. Takimet mund të mbahen një ose dy herë në vit. Para takimit duhet të propozohet një temë konkrete, që lidhet me praktikën e tyre në çështjet e dhunës ndaj grave dhe femicideve, të tilla si cilësimi juridik i veprës penale, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, pozita e viktimës (apo familjes së saj në rastet e femicideve), proceset penale, caktimi i dënimit, vendimi për dëmshpërblimin në kuadër të procesit penal etj.

Për më tepër, mund të organizohen konferenca dhe tryeza të ndryshme, duke i kushtuar vëmendje pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve të së njëjtës shkalle gjyqësore. Këto aktivitete mund të përdoren si procese joformale të vlerësimit të nevojave, në mënyrë që të sigurohet përmbajtje për takimet e ardhshme.

Aktivitetet e propozuara mund të ndikojnë për zbatimin e standardeve në lidhje me përgjigjen ndaj dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë femicidet, të forcojnë punën gjyqësore dhe të kontribuojnë për ndryshime pozitive përmes dialogut

rajonat, rrjetëzimit dhe zgjidhjes së problemeve në bashkëpunim, duke fuqizuar gjyqësorin me aftësinë për të marrë masa proaktive për të zhvilluar një praktikë gjyqësore më efektive dhe efikase, me ndjeshmëri gjinore.

» LITERATURA

- » Beker Kosana (ed.), Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Crnoj Gori, SOS Nikšić, 2023, mund ta gjeni në: <https://sosnk.org/wp-content/uploads/2023/04/Drustveni-i-institucionalni-odgovor-na-femicid-u-Crnoj-Gori-1.pdf>
- » Beker Kosana, Regional report: Social and institutional responses to femicide in Albania, Montenegro and Serbia, UN Women & FemPlatz, March 2023, mund ta gjeni në: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Regional-Report_Social-and-Institutional-Response-to-Femicide.pdf
- » Beker Kosana, Tanović Dalida (eds.), Analiza prakse sudova u procesuiranju femicida i pokušaja femicida u Bosni i Hercegovini 2017-2021, AIRE Centre, 2022, mund ta gjeni në: <https://www.airecentre.org/Handlers/Download.ashx?IDMF=77975c73-9c31-4552-9a68-3013255c0d5f>
- » Executive summary for Albania, mund ta gjeni në: <https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Social-and-Institutional-Response-to-Femicide-in-Albania.pdf>
- » Executive summary for Montenegro, mund ta gjeni në: <https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-04/Social-and-institutional-response-to-femicide-in-Montenegro1.pdf>
- » Hysi Vasilika, *et al.*, Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020), Center for Legal Civic Initiatives, Tirana, 2023, mund ta gjeni në: <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>
- » Hysi, Vasilika, Criminal acts against women and children and anti-crime policies in Albania, Reflections on changes to the Criminal Code (2012-2013), "Studime Juridike" Review. No. 2, 2014, Law Department, University of Tirana
- » Hysi Vasilika, Anastasi Aurela, Bozo Aurela and Vora Erisa, Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020), Center for Legal Civic Initiatives, Tirana, 2023

- » Interactive femicide map, FemPlatz, mund ta gjeni në: <http://femplatz.org/index.php?t16>

- » Konstantinović Vilić Slobodanka, Petrušić Nevena, Beker Kosana, Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Srbiji I, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo, 2019, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2019-11_Femicid_monografija_Prva_publicacija_E_primerak.pdf

- » Konstantinović Vilić Slobodanka, Petrušić Nevena, Pokušaji femicida i femicid u Srbiji: Sprečavanje i procesuiranje, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo & Niš, 2021, mund ta gjeni në: [http://femplatz.org/library/publications/2021-04_Femicid - Pokusaj femicida i femicid u Srbiji.pdf](http://femplatz.org/library/publications/2021-04_Femicid_-_Pokusaj_femicida_i_femicid_u_Srbiji.pdf)

- » Petrušić Nevena, Žunić Natalija, Vilić Vida, Društveni i institucionalni odgovor na femicid u Srbiji II, Udruženje građanki FemPlatz, Pančevo, 2019, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2019-11_Femicid_monografija_Druga_publicacija_E_primerak.pdf

- » United Nations Office on Drugs and Crime, UN Women, Gender-related killings of women and girls (femicide/feminicide), 2022, mund ta gjeni në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-11/Gender-related-killings-of-women-and-girls-improving-data-to-improve-responses-to-femicide-feminicide-en.pdf>

- » UNODC data on victims of intentional homicides for the period 2019-2021, mund ta gjeni në: <https://dataunodc.un.org/dp-intentional-homicide-victims>

- » World Population Review, Femicide Rates per Country for 2023, mund ta gjeni në: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/femicide-rates-by-country>

- » Габер-Дамјановска Наташа and Гајдова Габриела, Фемицидот во Република Северна Македонија – состојба, правна рамка и судска пракса (2018-2022), AIRE Centre, 2023, mund ta gjeni në: http://femplatz.org/library/publications/2023-09_femicide-report-nmk-2023-nmk.pdf [Gaber-Damjanovska Natasha and Gajdova Gabriela, Femicide in the Republic of North Macedonia – The state of affairs, the legal framework and the judicial practice (2018-2022), AIRE Centre, 2023, mund ta gjeni në: <https://gcjnetwork.org/femicide-report-nmk-2023-eng-4/>]

